



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS
SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 14 MARS 2020**

**SA VANREDNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 14. MARTA 2020. GODINE**

**MARS - MART
2020**

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i parë Projektligjit mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020.

Dnevni red

2. Prvo razmatranje Nacrt zakona o budžetskim podelama budžeta Republike Kosova za 2020.godinu.

Mbledhjen e drejtoi kryetarja e Kuvendit, zni. Vjosa Osmani.

KRYETARJA: Të nderuar deputetë,
Të nderuar zëvendëskryeministra,
Dhe ministra të Kabinetit qeveritar,
I hap punimet e seancës plenare të jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Ju njoftoj se kryeministri i Republikës së Kosovës, zoti Albin Kurti, në bazë të nenit 69, pika 4 të Kushtetutës dhe të nenit 38.2 të Rregullores së Kuvendit ka kërkuar seancë të jashtëzakonshme për shqyrtimin e Projektligjit mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020.

Në sallë janë të pranishëm 102 deputetë, që do të thotë kemi kuorum të mjaftueshëm për të proceduar.

Para se të procedojmë me Shqyrtimin e parë të Projektligjit mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, Kuvendi duhet të deklarohet që shqyrtimi i këtij projektligji të bëhet me procedurë të shpejtuar - shmangie nga afatet procedurale të parapara me dispozitat e Rregullores së Kuvendit.

Prandaj, ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, deputetin Rexhep Selimi, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë këtë propozim.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zonja kryetare!

I nderuar kryeministër,

Ministra,

Të nderuar kolegë dhe kolege deputete,

Seanca e jashtëzakonshme vjen si pasojë e një situatë të jashtëzakonshme që tashmë është e ditur sa i përket coronavirusit dhe ne sot për këtë arsye do të kërkojmë ose do të propozojmë një mocion procedural për shmangie të Rregullores së Punës së Kuvendit.

Kuvendi i Republikës së Kosovës në mbështetje të nenit 65, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 84 të Rregullores së Kuvendit, në seancën plenare të mbajtur sot, më 14 mars 2020, në lidhje me shqyrtimin e Projektligjit numër 07/L-001 mbi ndarjen buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, me propozim të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje të marrë këtë:

V E N D I M

1. Shqyrtimi i parë dhe shqyrtimi i dytë i Projektligjit numër 07/L-001 mbi ndarjen buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020 të bëhet me procedurë të përsheptuar, shmangie nga afatet procedurale, të parapara me nenin 56, paragrafi 1, me nenin 57, paragrafët 3, 5, 8 dhe 9 dhe nenin 64 paragrafi 4 të Rregullores së Kuvendit si në vijim:

1.1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit numër 07/L-001 mbi ndarjen buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020 të bëhet sot në seancën plenare, pra sot, më 14 mars 2020.

1.2. Pas miratimit të shqyrtimit të parë, amendamentet me Projektligjin numër 07/L-001 mbi ndarjen buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, mund t'i adresohen Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Transfere, pra sot pikërisht më 14 mars 2020, deri në përfundim ose pas përfundimit të seancës, pra të leximit të parë. Ne nuk mund ta parashikojmë se sa do të zgjasë seanca e parë me këtë rast, prandaj edhe nuk mund t'i ndaj me ju dinamikat se si do të procedohet kjo në Komisionin Funkcional dhe komisionet e tjera të përhershme. Prandaj propozimi im është në vazhdimësi që brenda këtij afati të respektohen të gjitha procedurat që Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Transfere, deri me një afat të caktuar, i cili mund të jetë i përafërt me orën 19:00 ose 19:30, duhet ta shqyrtojë projektligjin me raporte me rekomandime dhe t'ua paraqesë komisioneve të përhershme. Po ashtu edhe komisionet e përhershme brenda këtij afati t'i kryejnë detyrat dhe në fund neni 1.6, ngase nuk i lexova nga neni 1.2. deri në nenin 1.5.

Pra, 1.6, trajtimi i Shqyrtimit të dytë të Projektligjit 07/L-001 mbi ndarjen buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020 të bëhet sot, në të njëjtën ditë, në seancë plenar sot më 14 mars 2020, kurdo që përfundojnë këto procedura, duke i respektuar të gjitha procedurat e nevojshme.

Kemi pasur edhe raste të tjera, shembuj të tjerë që kemi kaluar buxhetin me procedura të përsheptuara. Prandaj, kërkoj nga ju, deputetë, që ta votoni këtë propozim për mocion procedural, pra këtë propozim-vendim të Kuvendit. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Para se t'ua kaloj fjalën grupeve parlamentare,
Të nderuar deputetë,

Po e shihni edhe vetë që është një situatë jo e zakonshme dhe për fat të keq, kjo sallë nuk i siguron kushtet e nevojshme që ne t'i respektojmë rekomandimet e Institutit për Shëndetësi Publike, i cili ndër të tjera kërkon që të jemi së paku një metër larg njëri-tjetrit, të mos preken sipërfaqet e njëjta. Ndër të tjera që edhe institucionet tona shëndetësore t'i kenë mjetet e mjaftueshme për t'u përballur me këtë gjendje, po ashtu edhe komunat tona.

Një sugjerim që të flisni secili nga vendi juaj, sepse foltorja tashmë u shfrytëzua nga një deputet. Qeveria do ta ketë të domosdoshme ta shfrytëzojë, por së paku ju të tjerët të jeni më pak të predispozuar ndaj një infektimi të mundshëm.

Ju njoftoj po ashtu që kjo sallë është dezinfektuar sot në mëngjes, por megjithatë kjo nuk është e mjaftueshme, sepse në qoftë se një deputet është i infektuar dhe i prek sipërfaqet e njëjta, mund të kalojë virusi. Pra, vetëm një sugjerim që të mos e shfrytëzoni foltoren sot në mënyrë që të jemi sa më larg njëri-tjetrit. Po shpresoj që sa më afër në qëndrime lidhur me miratimin e buxhetit.

Në emër të Lëvizjes Vetëvendosje, a ka nevojë dikush ta marrë fjalën tani lidhur me propozimin. Nuk ka nevojë.

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Arben Gashi.

ARBEN GASHI: E nderuar kryetare, faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Duke marrë në konsideratë faktin se ndarjet buxhetore për vitin 2020 nuk janë bërë, duke marrë parasysh dhe në konsideratë faktin se si rezultat i zgjedhjeve dhe vonesave në formimin e Qeverisë kemi ardhur në një situatë ku jemi pa buxhet dhe afatet ligjore të aprovimit të shtesa buxhetore po tejkalohen. Duke marrë parasysh se jemi në një situatë të emergjencës shëndetësore për shkak të pandemisë nga gripi.

Duke marrë parasysh rëndësinë e ndarjes buxhetore në efektet ekonomike që ajo mund t'i ketë dhe po ashtu duke marrë parasysh se sa e rëndësishme është për organet e shëndetësisë dhe shtabet e emergjencës që të jenë të pajisur me mjete financiare dhe mjete të tjera të domosdoshme, duke marrë parasysh se një pjesë e konsiderueshme e bizneseve, të cilat kanë kryer punë për institucione shtetërore nuk janë paguar për një periudhë relativisht të gjatë dhe ato biznese kanë nevojë që t'i paguajnë punëtorët e tyre dhe të kenë të hyrat buxhetore dhe pagesa nga institucione shtetërore dhe duke marrë parasysh angazhimin dhe domosdoshmërinë që të kemi një ligj të aprovuar për ndarjet buxhetore, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike i jap përkrahje propozimit të Qeverisë dhe propozimit të Lëvizjes Vetëvendosje që sot, mundësisht, t'i kalojmë të dy leximet dhe të kemi Ligjin për ndarjet buxhetore. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Memli Krasniqi, nga PDK-ja e ka fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, e nderuar kryetare!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Seanca e sotme do të kishte kuptim si e jashtëzakonshme nëse do të mblidheshim këtu për të trajtuar emergjencën e vërtetë në lidhje me shpërndarjen e coronavirusit COVID-19 edhe në vendin tonë.

Tashmë e dinë të gjithë që janë tri raste të konfirmuara dhe normalisht e dimë po ashtu që presim të ketë konfirmime të tjera të rasteve me infektim të këtij virusi edhe gjatë ditëve në vijim. Unë besoj që Qeveria sot vetëm një prioritet duhet ta ketë dhe prioriteti juaj duhet të jetë parandalimi i përkeqësimit të situatës në lidhje me coronavirusin dhe përkundër veprimeve që janë ndërmarrë, disa me vonesë, nuk po duket që jeni të përqendruar në këtë.

Po e citoj me shqetësim atë që para pak minutash e tha kryetari i Komunës së Vitisë, Sokol Haliti: “Kemi nevojë për ndihmë, kemi mbetur pa ndihmën e nivelit qendror, asgjë s’na kanë ndihmuar, nuk kemi nevojë për fjalime politike, qytetarët kanë nevojë për ndihmë, kemi nevojë për koordinim”. E dini, besoj, që kryetari i Komunës nuk u takon partive opozitare, po i takon një partie në koalicion.

Unë besoj që këtë kryetar edhe shumë të tjerë që janë duke deklaruar ngjashëm duhet t’i merrni seriozisht dhe për këtë e keni mbështetjen tonë, sepse deklarime të tilla sot edhe mbrëmë po dëgjojmë gjithandej, duhet të shqetësoheni për këtë edhe ju.

Në vend që ta sillni sot një plan nacional për ta trajtuar këtë pandemi, me një kërkesë edhe për buxhet konkret se si duhet të veprohet, ju po tentoni ta keqpërdoreni situatën e krijuar dhe panikun që, për fat të keq, tashmë është shpërndarë në opinionin publik.

Me sa kemi dëgjuar, keni marrë vendim si Qeveri që të ndahen 10 milionë euro, janë pak, ju them që janë shumë pak dhe ne sot ju ftojme që të vini me një vendim nëse ju duhet edhe mbështetja e Kuvendit për të ndarë së paku 25 milionë euro në fazën e parë, sepse as këto ndoshta në fund nuk do t’ju dalin. Ka nevojë që në çdo QKMF në të gjitha komunat, besa edhe në fshatra, e lë më në QKUK të ketë pajisje mbrojtëse dhe po i dëgjojmë punëtorët shëndetësorë që ato nuk ekzistojnë. Veprimet që janë ndërmarrë janë të domosdoshme, e mbështesim edhe ministrin e Shëndetësisë për veprimet e drejtat që i merr. Por, ju lutem që ta merrni më seriozisht dhe ta keni parasysh që kjo në këtë fazë definitivisht është prioriteti juaj.

Andaj kërkesa për kalim të buxhetit në mënyrë gati klandestine sot është e paarsyeshme. Vetëm një herë ka ndodhur të kalojë buxheti kështu qysh po kërkonte ju në vitin 2015, zëvendëskryeministrit Hoti i kujtohet, se ka qenë ministër i Financave, asnjëherë tjetër s’e kemi kaluar buxhetin në këtë Kuvend, dy lexime për një ditë.

Tek e fundit kanë kaluar më shumë se 40 ditë prej që e kemi votuar Qeverinë, vonesat janë faji ekskluziv juaj, është përgjegjësi ekskluzive juaja. Ju deri dje s’na keni sjellë as programin e

Qeverisë e as projektbuxhetin. Qe po e marrë vetëm si shembull, në 2017 në momentin që është votuar Qeveria, brenda dy javësh është votuar edhe rishikimi dhe është punuar menjëherë në buxhet. Ka pasur edhe një herë një Qeveri në vitin 2011, nëse nuk gaboj, që është votuar në fund të shkurtit, as zgjatje buxhetore s'ka pasur nevojë të bëhet, sepse e kemi votuar Qeverinë menjëherë.

Vendimin që po e kërkoni nuk është thjesht veç zgjatje e ndarjeve buxhetore, kur e sollët para disa jave, ne si opozitë e votuam vazhdimin e ndarjeve buxhetore për muajin mars. Jua përkujtova atë ditë, po jua përkujtoj edhe sot, të njëjtën ju që tash jeni në Qeveri, kur ishit në opozitë, nuk e keni bërë për Qeverinë e kaluar dhe arsyetimi ka qenë krejtësisht i njëjtë, këto s'janë ndarje buxhetore, është buxheti i shtetit, është buxheti i qytetarëve për krejt vitin 2020.

Janë projekte, të cilat i presin gati dy milionë qytetarë dhe, në fund të fundit, nga ajo që e kemi parë për kaq pak kohë sa keni pasur prej kur e keni sjellë këtë draft-buxhet, realisht është një buxhet i keq që nuk i adreson as nevojat as kërkesat e qytetarëve, e aq më pak premtimet që i keni dhënë në fushatë zgjedhore dhe për çka e keni marrë edhe votën e qytetarëve.

Pra, tendenca juaj sot është për ta kaluar buxhetin në dy lexime brenda ditës, siç e thatë drejtpërdrejt, por vonesat i keni shkaktuar vetë, nuk ju ka faj bash askush, aq më pak opozita që nuk e ka asnjë punë në këtë proces. Pra, s'mund të kërkoni mbështetje nga opozita për t' i zgjidhur problemet që ia keni shkaktuar vetes, e për fat që keq ndoshta edhe qytetarëve.

Me këtë qasje nuk besoj që mund të kemi një dakordancë për ta mbështetur mocionin dhe po e përsëris në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës që çdo vendim e çdo veprim të drejtë, në lidhje me trajtimin e pandemisë së coronavirusit e keni mbështetjen e plotë, 100%, bile mos u bëni modestë në kërkesa nëse ju duhet mbështetja Parlamentit, sepse ky është shqetësim i secilit qytetar në vendin tonë e yni duhet të jetë edhe obligim, para së gjithash. Por, buxheti duhet të kalojë në procedura të rregullta dhe për këtë ne jemi të gatshëm.

Shikoni, ne jemi deputetë dhe obligimi ynë është t'u shërbejmë qytetarëve edhe në gjendje të jashtëzakonshme, këtë e kemi obligim kushtetues, tek e fundit, dhe nëse nesër shpallet gjendja e jashtëzakonshme, siç ka ndodhur në disa shtete anembanë globit, ne duhet vazhduar punën.

Adoptimi i hapësirave të Kuvendit mund të ndodhin deri në seancën e rregullt që mund të mbahet menjëherë javën e ardhshme, ashtu siç ka qenë e planifikuar dhe ne jemi të gatshëm që të përmbushim obligimin tonë kushtetues dhe për të mirën e për pritjet e qytetarëve të vijmë në seancë sa herë që doni, sa herë të na thirrni, qoftë seanca të rregullta, qoftë seanca të jashtëzakonshme. Por, ju lutem, edhe një herë mos e keqpërdorni situatën vërtet ashtu të rënduar, mos e keqpërdorni frikën e të drejtë për të panjohurën që tashmë e ka kapluar opinionin publik

për t'u munduar ta kaloni buxhetin, i cili nuk varet dhe nuk lidhet drejtpërdrejt me situatën rreth pandemisë për coronavirusin. Faleminderit!

KRYETARJA: Daut Haradinaj, urdhëro!

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryetare!

E di që shumica e qytetarëve ishin gëzuar, bile, po të na binte virusi!

Tash për temën të cilën jemi thirrur, e para, pse është thirrur e jashtëzakonshme, është keqpërdorur pak situata emergjente, e cila është në Kosovë dhe si Aleancë jemi dakord, në rast se do të ketë një propozim për një fond të veçantë rreth trajtimit të kësaj teme, ne do të marrim pjesë në votim. Pra, nëse është e ndarë nga projektbuxheti. Ndërsa sa i përket projektbuxhetit, është absolut domethënë një masakër që ka ndodhur sidomos në infrastrukturë, ku s'ka mbetur projekt pa u goditur.

Nuk e di qysh e kanë menduar, e kam marrë një tabelë prej shumicës së komunave, e kam këtu, në rast se hapet debati, një për një do t'i lexoj, qysh kanë qenë, qysh janë, pse? Shumica prej tyre janë të Qeverisë Mustafa të nisura, të vazhduara dhe janë në përfundim e sipër.

Tjetra është, në rast se brenda këtij fondi nëse propozohet për t'i suportuar financiarisht kategoritë e caktuara, të cilat janë duke e trajtuar këtë temë, si policinë, shëndetësinë, emergjencat, ne jemi shumë të gatshëm për të mbështetur edhe me votë, edhe në çdo formë, vullnetare nëse është nevoja, do të jemi në dispozicion të tejkalimit të kësaj krize, sepse kjo nuk është krizë e Qeverisë, kjo është krizë globale edhe e popullit të Kosovës.

Të njëjtën kohë, sot gjatë ditës shumica e kolegëve të mi që janë edhe mjekë kanë marrë telefonata pothuajse nga të gjitha qendrat, qoftë spitalet regjionale, QKMF-të e komunave, ku akoma nuk është parë dora e shtetit. Pra, nëse dikush mendon që coronavirusi ruhet me polici edhe kallashnikov në kryq të Klinës, është gabim. Ndërsa në rast se shkoni ju e i shihni në çfarë gjendje funksionojnë stafi shëndetësor në atë komunë apo në Viti, as gjërat elementare nuk i kanë. Pra, duhet marrë masat urgjentisht, ka forma, Qeveria mund të mblidhet, t'i votojë, t'i tejkalojë procedurat dhe t'u ndihmohet atyre se kanë nevojë urgjentisht.

Te infrastruktura, për shembull, stadiumit të Gjakovës ia kanë hequr komplet buxhetin, ia kanë lënë 100 mijë euro. Rrugën e Plavës, zoti kryeministër, s'e ke prejardhje, të kam komshi atje, me 400 mijë euro një urë të vetme nuk e rregullon, një anësore s'mund t'ia rregullosh asaj rruge, plus e dini rëndësinë, nuk është rrugë e një regjioni, bile është rrugë ndërshtetërore edhe ishte dashur të ketë prioritet dhe të masakrohet në atë formë.

Rrugën Gjakovë-Klinë, e cila është në zbatim e sipër, janë hequr fondet, qarkorja e Gjakovës në drejtimin e Prizrenit janë hequr fondet, ajo është duke u kryer. Qarkorja në drejtimin e Pejës

është duke u kryer. Shtëpia e Kulturës “Ukë Bytyqi” në Suharekë - janë hequr mjetet. Në Rahovec s’ka projekt që s’është godit. E kam tabelën, e thashë edhe një herë këtu, po të shihet gjendja se çka kanë bërë, është e patolerueshme. Në rast se dikush mendon që në këtë formë qeveriset Kosova, e ka shumë gabim.

E të mos flasim, për shembull, që nuk është paraparë zbatimi i Ligjit për paga, e kanë bërë një fond në të cilin thirren dhe brenda atij fondi kanë ide se ku do t’i orientojnë këto mjete, por nuk është paraparë në linjat buxhetore zbatimi i Ligjit për pagat. Do të thotë është duke u paragjykuar një vendim që vjen nga Gjykata Kushtetuese, e brenda këtij ligji kategoritë e trajtuara janë pikërisht mjekët që sot i kemi heronjtë e ditës, janë policitë, zjarrfikësit, janë të gjitha kategoritë, të cilat ballafaqohen sot drejtpërdrejt me këtë problem.

Pra, shkurt, nuk po e zgjas më shumë. Në rast se Qeveria bie një linjë buxhetore të veçantë për trajtimin e krizës së krijuar, ne si Aleancë jemi për, në rast se tentohet me mocion procedural t’i shmangeni rendit të ditës, ne e dimë që ju duhen 2/3 nuk do t’i keni dhe kështu kjo seancë përfundon. Faleminderit!

KRYETARJA: Nga Lista serbe nuk e ka kërkuar askush fjalën. Fatmir Limaj e ka fjalën.

FATMIR LIMAJ: Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar kolegë,

I nderuar kryeministër,

Ministra,

Ne kemi pritur që Kuvendi të shfrytëzojë një seancë të jashtëzakonshme për ta mbështetur Qeverinë e Republikës së Kosovës për masat që po i merr dhe nevojat shtesë për përkrahjen e domosdoshme, për situatën e krijuar në vendin tonë.

Dhe, në këtë drejtim, ne si Nismë, besoj edhe të gjithë deputetët e Parlamentit të Kosovës do të jenë të gatshëm për t’i dhënë mbështetje Qeverisë së Kosovës, të gjitha nevojat që paraqiten për të marrë masat e nevojshme ndaj kësaj epidemie.

Seanca e jashtëzakonshme për buxhetin e Kosovës në këto rrethana, e kërkuar, ne mendojmë jo që nuk është e qëlluar, por është e pandershme. Në qoftë se Qeveria e Republikës së Kosovës në fondet që ka ndarë ka nevojë për fonde shtesë, sikur që u tha edhe nga kolegët, ne do të jemi të gatshëm çdo herë të japim kontributin tonë për fonde shtesë për ta ndihmuar Qeverinë për të dalë nga kjo situatë e jashtëzakonshme. Mirëpo të shfrytëzohet kjo situatë e jashtëzakonshme për të votuar ligjin më të rëndësishëm në Parlamentin e Kosovës është të shfrytëzohet pandershmërisht situata e krijuar në vend.

Buxheti, si ligji më i rëndësishëm, është një mundësi për deputetët e Parlamentit për të shfaqur kritikën, mendimet, sugjerimet, amendamentimet rreth këtij ligji të rëndësishëm njëvjeçar. Nuk ka debat më të rëndësishëm në Parlament të Kosovës se sa ky. Sot Qeveria e Kosovës po tenton të shfrytëzojë situatën e jashtëzakonshme që në njëfarë mënyre për ta përvjedhur shpejt e shpejt miratimin e këtij buxheti dhe kjo është e turpshme.

U thanë edhe për shkak të kushteve të Kuvendit të Kosovës, që me mundësi të kufizuara të punojë Kuvendi i Kosovës, unë besoj që edhe kjo nuk duhet të ceket. Ka sektorë të rëndësishëm të shoqërisë sonë, duke filluar nga punëtorët shëndetësorë, nga ata të sigurisë, policia, zjarrfikësit, punëtorët, të cilët edhe në këto rrethana po i kryejnë detyrat e veta, atë obligim që e kanë me ligj. Edhe ne si deputetë të Parlamentit të Kosovës duhet të krijohen kushtet dhe duhet të jemi vazhdimisht sipas situatës në detyrë, duke i përmbushur obligimet tona ligjore e kushtetuese.

Buxheti i Republikës së Kosovës duhet të trajtohet në seanca të rregullta dhe jo të jashtëzakonshme dhe nuk duhet të shfrytëzohet kjo situatë për të ikur ose për të shmangur e për të mbytur debatin, për të mos i dhënë mundësi debatit, për të mos u dhënë kohë të mjaftueshme deputetëve ta trajtojnë projektbuxhetin që pastaj të mund të paraqesin amendamentet dhe kritikata e tyre.

Për më tepër, sot po kërkohet miratimi i buxhetit pa e parë programin e Qeverisë, imagjinoni, neve sot na kërkohet shmangia për ta votuar buxhetin e Kosovës pa e prezantuar Qeveria programin e vet. Të gjitha këto tregojnë që më tepër është tendencë për ikje, të shfrytëzohet kjo situatë e keqe, këtë gjendje të jashtëzakonshme që nuk është vetëm në Kosovë, për të nxjerrë ose për të miratuar buxhetin dhe për të mos u dhënë mundësi njerëzve këtu, deputetëve të Parlamentit të Kosovës, t'i shprehin mendimet dhe qëndrimet e tyre rreth këtij buxheti.

Në një situatë të tillë ne vlerësojmë që neve kjo na pamundëson t'i kryejmë detyrat tona Ne besojmë që nuk ka asnjë rrethanë të jashtëzakonshme për Parlamentin e Kosovës që të trajtojë e t'i zhvillojë punimet rregullisht, t'i kryejë detyrat që i takojnë.

Ne si Nismë jemi kundër, do të votojmë kundër këtij mocioni dhe kërkojmë që propozuesi ta tërheqë mocionin, të kthehemi në gjendje normale, fillojnë komisionet t'i kryejnë detyrat e tyre, t'u jepet mundësi deputetëve të Parlamentit që të studiojnë deri në fund këtë projektbuxhet, sikur që e thashë, është ligji më i rëndësishëm njëvjeçar në Republikën e Kosovës.

Në fund, është nisur keq kjo, vërtet është nisur keq kjo duke e shfrytëzua këtë situatë të miratohet buxheti, është një sinjal jo i mirë. Prandaj, ne jemi kundër dhe do të votojmë kundër një mocioni të tillë. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar 6+, Albert Kinolli e ka fjalën.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, e nderuar kryetare e Kuvendit!

Kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Nuk do mend që secili prej nesh, edhe ne po ashtu kishim pasur dëshirë që në kushte dhe rrethana shumë më të volitshme dhe më normale të diskutojmë ndoshta projektligjin më të rëndësishëm, buxhetin, për shkak se ne në kohë të pamjaftueshme apo kemi pasur relativisht kohë shumë të shkurtër që ta shqyrtojmë projektligjin për këtë vit dhe nevojat e qytetarëve dhe komunitetit tonë që secili këtu prej neve përfaqësojmë janë shumë të rëndësishme.

Mirëpo, duke pasur parasysh vetë faktin se në çfarë situatë gjendemi dhe nevoja është imediate, duke pasur parasysh edhe coronavirusin dhe, edhe QKMF-të, edhe QKUK-ja, edhe krejt mantelbardhët, edhe ata që janë duke luftuar këtë virus kanë nevojë për mbështetje financiare. Ne e kemi parasysh edhe nevojën e qytetarëve. Ne do të votojmë pro mocionit. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit!

Vetëm një informatë të shkurtër. Pardje ka ardhur Programi i Qeverisë dhe unë menjëherë e kam përcjellë te deputetët. Tash na vjen informata në qoftë se tashmë është. Disa po e konfirmojnë që e kanë marrë programin. Kryeministri e ka fjalën. Pastaj do të shkojmë në votim.

KRYEMINISTRI ALBIN KURTI: Faleminderit kryetare e Kuvendit, Osmani!

Të nderuar deputetë,

Zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,

Kjo situatë është e pazakonshme, por e pazakonshme edhe në kuptimin që ne nuk e kemi hasur një gjë të tillë si Qeveri e si legjislaturë e që prej çlirimit e këndej. Bëhet fjalë për një pandemi botërore dhe ne urojmë që në ditët dhe javët në vijim të arrijmë ta ulim shpejtësinë dhe gjeografinë e shtrirjes së kësaj pandemie, përkatësisht coronavirusit, apo COVID-19.

Edhe ne nuk do të dëshironim që gjithçka të bëhet brenda një dite, por kemi konsideruar që është e nevojshme të mblidhemi sot edhe pse është e shtunë, meqenëse nuk ka garanci që do të mund të mbajmë seanca në javët apo në ditët në vijim, sepse nuk e dimë çfarë do të ndodhë me përhapjen e coronavirusit.

Edhe kështu siç jemi në këtë sallë, në fakt jemi në kundërshtim me rregullat të cilat vetë ne i themi, për shkak të rekomandimit të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike.

Kemi krijuar edhe Komisionin e posaçëm për këtë, me 26 anëtarë gjithsej dhe po bëjmë maksimumin tonë me angazhimet e pandërprera. Por, nuk mund të kemi një buxhet emergjent pa

e pasur buxhetin e ri. Na nevojitet buxheti 2020 dhe vetëm më pas ne mund të kemi buxhet emergjent. Edhe ashtu në muajin mars jemi me një të dymbëdhjetën e buxhetit.

Në vitin 2011 kanë qenë dy lexime, më 25 mars dhe më 31 mars, po nuk ka pasur coronavirus. Edhe atëherë në ditën e fundit, pra në ditën e fundit të muajit mars pat kaluar në lexim të dytë buxheti. Prandaj, duke pasur parasysh këtë rrethanë në të cilën ndodhemi, unë ju ftoj që ta kalojmë sot buxhetin, ta votojmë propozimin e shefit të Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes, z. Rexhep Selimit dhe duke theksuar në fund që ky buxhet nuk është as për së afërmi i ri, qysh është Qeveria e re. Ky buxhet nuk është i ri, qysh është Qeveria e re. Janë gjithsej 326 milionë euro obligime paraprake. Kur kemi parasysh se struktura e të hyrave, por edhe e shpenzimeve nuk ka ndonjë dallim drastik, kjo në fakt është dëshmi se buxheti i vitit 2020 fatkeqësisht nuk është i ri si Qeveria jonë, meqenëse nuk jemi në muajin nëntor të vitit 2019, por jemi në muajin mars të vitit 2020. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Vetëm edhe një sqarim. Propozimi nuk është për ta ndaluar debatin. Pra, debat do të kemi sot sa të doni. Vetëm për t'i përshpejtuar procedurat e tjera.

Edhe një herë, propozuesi Rexhep Selimi e ka fjalën para se ta vendosim mocionin në votim.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, kryetare!

I dëgjova me vëmendje të gjithë kolegët e mi, kryetarë të grupeve parlamentare. Po i kuptoj edhe shqetësimet e tyre, siç duhet t'i kuptojë mazhoranca shqetësimet e opozitës, por po e shoh të nevojshme, nëse kam mirëkuptimin e tyre gjithsesi, që të kërkoj një konsultë shtesë, një pauzë të gjithë kryetarët e grupeve parlamentare që ta diskutojmë edhe një herë çështjen e nevojës për mocion ose jo. Kështu që propozimi im i radhës është që të kemi një pauzë të shkurtër dhe ta kemi një konsultë të gjithë shefat e grupeve parlamentare, për ta diskutuar edhe një herë, sepse vërtet kemi çka të flasim, vërtet kemi çka të diskutojmë, dhe pastaj vendimi jonë i përbashkët të jetë gjithsesi në shërbim të qytetarëve të këtij vendi.

Unë nuk dua t'i komentoj e as t'i replikoj kolegët e mi, sepse edhe kam çka t'i komentoj edhe çka t'i replikoj për gjithë atë çfarë u tha, por Kryeministri e tha, edhe ne po e përsërisim që për të gjitha ato kërkesa që sot janë si nevojë e përgjigjes sonë ndaj krizës nuk mund të kalojnë pa kaluar edhe Buxheti. Pra kërkesat në përgjithësi janë buxhetore dhe ka nevojë që buxheti i ri t'i plotësojë këto kërkesa. Prandaj, do të kërkoj një pauzë të shkurtër që t'i konsultoj kolegët e mi, kryetarët e grupeve parlamentare.

KRYETARJA: Atëherë po i ftoj të gjithë kryetarët e grupeve parlamentare për një konsultim dhjetëminutësh në zyrën time. Kryetarët e grupeve parlamentare i ftova, jo juve zoti deputet.

(Pauzë)

KRYETARJA: Ju lutem, zini vendet!

Të nderuar deputetë,

Ju njoftoj që kryetarët e grupeve parlamentare kanë kërkuar 30 minuta shtesë për t'u konsultuar përbrenda grupeve të tyre, kështu që i ftoj të gjitha grupet që të mbliidhen dhe pas 30 minutash do të shihemi këtu në seancë

30 minuta i kanë kërkuar grupet parlamentare. Në orën 17:20, përafërsisht.

(Pauzë)

KRYETARJA: Të nderuar deputetë!

61 deputetë janë në sallë. Ju lus të përgatiteni për votim, meqenëse kemi pritur mjaft.

Përgatituni për votim të mocionit të paraqitur nga zoti Rexhep Selimi.

Votojmë tash!

Me dorë praktikisht, meqenëse nuk janë duke punuar kartelat.

Kush është për? Mbajeni sa më gjatë dorën ju lutem! Sa? 64 me deputeten Besa Gaxherri.

A ka kundër? Kush është kundër?

A ka abstenime? Nuk ka abstenime.

Me sa vota për ju lutem?

62 vota për, 2 deputetë nuk kanë marrë pjesë në votim. Me 62 vota për, kalon mocioni i z. Rexhep Selimi.

Ju faleminderit!

Procedojmë me rendin e ditës:

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020

Më lejoni fillimisht t'i lexoj disa konstatime hyrëse. Komisioni funksional për buxhet dhe transfere në bazë të nenit 56 të Rregullores, ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka

rekomanduar miratimin e tij. Ftoj ministrin e Financave dhe Transfereve, z. Besnik Bislimi që para deputetëve të Kuvendit të prezantojë dhe arsyetojë Projektligjin. Urdhëroni zoti ministër!

MINISTRI BESNIK BISLIMI: E nderuar kryeparlamentare Osmani!

I nderuar Kryeministër, z. Kurti

Të nderuar kolegë ministra,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Të nderuar qytetarë,

Jam sot këtu para jush me detyrën që të prezantojë Projektligjin mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020.

Pa dyshim se secili prej nesh ka paramenduar dhe dëshiruar rrethana të tjera për ta diskutuar mbase dokumentin më të rëndësishëm kur bëhet fjalë për rolin e sektorit publik në jetën e qytetarëve të vendit. Por, ashtu si edhe u cek në adresimin e mëparshëm të Kryeministrit, gjendja e krijuar nga përhapja e infeksionit me coronavirus në Evropë, rajon e nga dje edhe në Kosovë, na dikton nguti në adoptimin e këtij dokumenti të rëndësishëm.

Fillimisht dua të falënderoj secilin prej jush të nderuar deputetë për votimin e propozimit të ministrit të Financave e Transfereve për zgjatjen e pagesave nga buxheti i Kosovës edhe për muajin mars në masën 1/12 të Ligjit të buxhetit të vitit paraprak. Njëkohësisht shfrytëzoj rastin të falënderoj publikisht të gjithë zyrtarët si nga Ministria e Financave dhe Transfereve por edhe nga Ministrinë e tjera për punën e palodhshme që kanë investuar në mënyrë që ky dokument të jetë gati para jush sot.

Nisur nga limitimet kohore, unë do të përpiqem që fjalimin tim ta mbajë sa më të shkurtër. Shkurtimisht për projeksionet dhe pikat kryesore, indikatorët kryesorë në buxhet. Në Projektbuxhetin e vitit 2020 kemi një rritje në krahasim me të hyrat totale të realizuara në vitin 2019, me 6,9 për qind ose një rritje prej 131 milionë euro. Kjo rritje është e parashikuar si për të hyrat tatimore, ashtu edhe jotatimore. Sa u përket shpenzimeve të planifikuara, shpenzimet e përgjithshme pritet të rriten për 12,7 për qind në krahasim me shpenzimet e realizuara në vitin 2019, ose një rritje prej 266 milionë euro, edhe atë në masën e 2 miliardë e 357 milionë.

Deficiti buxhetor pritet të jetë 2% ose 147 milionë euro, ashtu siç është e paraparë me rregullën fiskale. Mbi këtë deficit do të ketë financim shtesë nëpërmjet klauzolës për investime në shumë prej 77 milionë eurove dhe nga fondi i Agjencisë Kosovare për Privatizim në masën e 85 milionë eurove.

Ky deficit është i planifikuar të financohet nga emetimi i letrave me vlerë dhe nga financimi i jashtëm.

Indikatorët kryesorë buxhetorë të listuar më lart janë derivuar nga parashikimet makroekonomike dhe ato fiskale për vitin 2020 dhe vitet vijuese.

Në vitin 2020, parashohim një rritje ekonomike prej 4,2% në terma real, ndërsa në ato nominale do të jetë mbi 5%. Inflacioni është projektuar të jetë mesatarisht 1,3% në baza vjetore. Projektionet janë kredibile dhe paraqesin gjendjen reale, mirëpo duhet të theksohet se ky parashikim ka qenë para gjendjes së krijuar si rezultat i COVID-19.

Në mbledhjen e Komisionit për Buxhet dhe Financa, ju kam informuar edhe për ndryshimet që i kemi ndërmarrë në pjesën tekstuale të Ligjit për Buxhetin, dhe për intervenimet që i kemi bërë në nenin 3, 6, 11, 12, 13, 16, 18 dhe 24.

Me shkrim do t'ju informoj për secilin prej intervenimeve në pjesën tekstuale dhe logjike, pra për këto intervenime.

Te pjesa tabelare, shkurtimisht dua t'ju informoj se në observimin fillestar nga ana e ministrisë, kemi identifikuar dallim të madh mes stafit të aprovuar nëpër organizata buxhetore dhe atij aktual, andaj edhe i kemi bërë përshtatjet e duhura.

Në nivelin lokal, kjo ka qenë e pamundur për arsye se buxhetet e komunave kanë qenë të aprovuara nëpër asambljetë komunale, ndërkaq në atë qendror, kemi një korrigjim prej diku 760 pozitave.

Po i kaloj këto pjesë, në mënyrë që sa më shpejt të kalojmë në votim.

Në përfundim, dua vetëm t'ju tërheq vëmendjen për dy gjëra. E para, ky projektligj me rregullimet që i kemi bërë, përfshirë këtu intervenimet në pjesën tekstuale, pastrimi nga keqklasifikimet, modifikimi i projekteve me financim nga klauzola e investimeve, ulja e shpenzimeve për mallra dhe shërbime dhe ngritja e kontingjencës për t'u përballur me koston eventuale të nismave dhe vendimeve ligjore të Qeverisë së papërgjegjshme, është dukshëm më i avancuar, më i mirë dhe më realist sesa drafti i përgatitur nga Qeveria në ikje.

Por, megjithatë, mbetet larg një dokumenti që do të reflektonte prioritetet e Qeverisë së re. Rrjedhimisht, ne si Qeveri jemi të obliguar që shumë shpejt të fillojmë punën për rishikimin e dokumentit të buxhetit.

Së dyti, pak fjalë edhe për përmasat e realizmit gjatë kalkulimit të parashikimeve ekonomike e fiskale.

Është përtej çdo dyshimi që paparishikueshmëria e kohëzgjatjes dhe magnetudës së ndikimit të vendit nga infeksioni me coronavirus, si aktiviteti ekonomik, ashtu edhe të hyrat tatimore e shpenzimet buxhetore do të ndikohen.

Përderisa trendi tek aktiviteti ekonomik dhe të hyrat tatimore, pritet të jetë negativ, kërkesa për shpenzime shtesë buxhetore janë në vazhdimësi në rritje. Këto kërkesa janë direkte për përballjen e stafit mjekësor dhe atij përcjellës me pasojat e virusit. Pastaj nevojat për intervenim serioz dhe të munguar prej kohësh në kompensimin dhe rezervave shtetërore, ashtu edhe domosdoshmëria që të intervenohet edhe në programe sociale për t'i dalë ndihmë asaj pjese të shoqërisë, e cila si rezultat i paralizimit të jetës ekonomike, do të përballlet me rënie të të ardhurave në afat të shkurtër si dhe me shpenzime të papërballueshme në buxhetin familjar.

Në këtë kontekst, neve na mbeten pak opsione. Përveç detyrimit për përshtatje të parashikimeve ekonomike, rrjedhimisht edhe potencialit tatimor të sektorit privat, do të jetë e domosdoshme edhe përshtatja e kompozimit të shpenzimeve publike që kryesisht do të manifestohet tek ato për projekte kapitale.

Në të njëjtën kohë, do të kemi nevojë për intensifikim të angazhimeve me mekanizmat kyç të financimit bilateral dhe multilateral si, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore, BERZH-i, KFF e të ngjashme, për mbështetje në përballimin e kostos së luftimit të infeksionit me coronavirus.

Në këtë drejtim, ne veç kemi aprovuar një shumë initiale prej 10 milionë eurosh nga kontingjenca në Ministrinë e Financave, kurse Banka Botërore na kontaktuar dhe ka sinjalizuar mundësinë e shfrytëzimit të një dritareje në përballje emergjente, përfshirë këtu edhe përkrahjen me koston ekonomike në masën 7,9 milionë dollarëve amerikanë.

Të nderuar deputetë,

Po e përfundoj adresimin tim, me lutjen që në këtë situatë në të cilën ndodhemi, të tregojmë se jemi bashkë, duke votuar unanimisht këtë projektligj, dhe duke e lutur edhe presidentin e vendit që mundësisht gjatë ditë së sotme ta nënshkruaj aprovimin e dokumentit.

Kjo na jep shumë më tepër fleksibilitet që t'i përcjellim punët emergjente të secilës ministri, por edhe të agjencive të tjera shpenzuese, si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal. Ju faleminderit shumë dhe ju ftoj që të votoni në parim.

KRYETARJA: Faleminderit! Fjalën e ka Hekuran Murati, kryetar i Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa.

HEKURAN MURATI: Ju faleminderit, e nderuar kryetare!

Komisioni për Buxhet dhe Transfere, në bazë të nenit 56, paragrafi 2, i Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 13 mars, shqyrtoi në parim projektligjin nr. 07/L-001 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020 dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë rekomandim:

Të miratohet në parim projektligji nr. 07/L-001 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020.

A R S Y E T I M

Në bazë të nenit 56, paragrafi 2, të Rregullores së Kuvendit para shqyrtimit të parë të projektligjit, në mbledhje plenare Komisioni Funkcional shqyrton projektligjin në parim dhe Kuvendit i paraqet raport me rekomandim:

Komisioni, pas shqyrtimit në parim të projektligjit mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, vlerësoi se projektligji i përmbushë kushtet e parapara me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe i rekomandon Kuvendit për miratim në parim.

Po ashtu në kuadër të grupit parlamentar, një vlerësim mbi projektligjin, duke i pasur parasysht sfidat kohore që kanë qenë, konsiderojmë që është një buxhet i përgatitur në mënyrë solide e sidomos duke e marrë parasysht edhe stafin profesional që ka punuar në të.

Të hyrat paraqesin një rritje prej 7% krahasuar me vitin e kaluar, gjë që nënkupton dhe shpresojmë që do të kemi të hyra më tepër sesa rritja e GDP-së, e kjo nënkupton edhe luftim të evazionit fiskal. E në anën tjetër, duke pasur parasysht edhe sfidat që kanë qenë me shpenzimet që kanë qenë të paralokume kryesisht që përbëjnë rreth 1.6 miliardë euro, që kanë qenë të paradedikuar, përfshirë pagat, mallrat dhe shërbimet si dhe transferet, shuma që ka mbetur e alokuar për shpenzimet kapitale, po ashtu ka qenë e kufizuar, duke e marrë parasysht që një numër i madh i projekteve kanë qenë të dedikuara.

Lidhur me këtë, ka pasur kritika më së shumti edhe prej vet grupit, të cilët kanë qenë kritik ndaj shumicës së projekteve që kanë qenë të përfshira në këtë projektligj, por duke e marrë parasysht gjendjen e krijuar, gjendjen e jashtëzakonshme edhe rastin me situatën që është paraqitur me këto rastet e konfirmuara me coronavirus, konsiderojmë që ky projektligj duhet të miratohet, prandaj e mbështesim. Ju faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetare!

Grupi Parlamentar i LDK-së, e ka shqyrtuar projektbuxhetin e vitit 2020. Duke e marrë në konsideratë se tashmë jemi në gjysmën e muajit mars, çështja mendoj se kërkon urgjencë dhe për këtë arsye, ne si grup parlamentar mendojmë se buxheti është i formuluar mirë, ndërsa vërejtjet specifike që i kemi ose propozimet shitesë do t'i adresojmë nëpërmjet amendamenteve në komisionin përkatës. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, z. Bedri Hamza.

BEDRI HAMZA: Faleminderit, znj. kryetare!

I nderuari kryeministër,

Zv/kryeministra,

Ministra,

Të nderuar deputetë,

Ky është minimumi i korrektesisë që mund ta ketë dikush. Jemi ftuar, po e them realitetin, pa asnjë shtrembërim, do të mund të më vrisnit, të më prisnit sot ose çfarëdo tjetër do të mund të më bënit, por unë të paktën, në natyrën edhe në edukatën time, nuk është që unë t'ia bëj dikujt këtë.

Jemi ftuar edhe po e them realitetin, asnjë shmangie nga realiteti. Jemi ftuar si shefa të grupeve, si kryetarë të grupeve parlamentare në zyrën e kryetares së Kuvendit. Kemi diskutuar sesi të gjemë zgjidhjen më të mirë, më optimale, e mirë për pozitën për opozitën, po mbi të gjitha për vendin. Dhe, ne si parti opozitare do të mundim të mos dilnim fare nga salla, znj. kryetare, të rrinim në sallë dhe të themi, mocionin ose tërhiqe ose qite në votim, dhe ju e dini që s'i keni pasur numrat. Nuk ka qenë qëllimi ynë aty. Absolutisht, nuk ka qenë qëllimi ynë aty.

Jemi dalë më pauzë, jemi konsultuar, kemi debatuar. Secili grup parlamentar, ka numër të madh të deputetëve, dikush i ka 24, dikush pak ose më shumë, dhe secili prej tyre, ka të drejtë që ta shprehë qëndrimin e vet. A duhet të dëgjohen që të vinë te një konsensus, të njëjtin si kryetar i grupit parlamentar apo dikush nga grupi parlamentar ta prezantojë këtu në Kuvend.

E tash, më herët nuk do i thosha të gjitha kështu, tash, bash ky është trafikim i buxhetit. Bash, kjo sjellje është mos mbajtje e fjalës. Bash, kjo sjellje lëndon. Unë besoj se këtij vendi do t'i nevojitet bashkëpunimi pozitë-opozitë edhe në raste të tjera. Edhe në momente të tjera.

Si të besoj unë? Unë jam i gabueshëm. Unë kam gabuar. Unë do të gabo. I kuptoj dallimet politike, po këtë do të mund ta bënit vetëm ju. Keni mbërri diçka, buxheti tekefundit nëse s'kalon sonte, do të kalonte brenda 3-4 ditëve, 4-5 ditëve, po tekefundit do të kalonte edhe në një afat tjetër.

Qeverisë i kam treguar me kohë, në mënyrën më të butë që e kam ditur dhe kam mundur, që je duke u vonuar. Është vonuar dhe problemi nuk është coronavirusi, është mospërgatitja e buxhetit edhe procedimi i buxhetit në kohë.

E keni mbyllë derën për të pasur komunikim me Partinë Demokratike për çështjet për të cilat iu vyen konsensusi. Na keni thirr, na keni qit prej salle. Para se të vinit, do të mund të thoshit, i thërrasim deputetët e opozitës që të vijnë në sallë, t'i bini ziles...

Në rregull, në rregull janë ato, ok, ok! S'kemi qenë duke pirë kafe në bufe. E keni ditur se i keni 60 e sa numra, i kuptojmë ne këto teknike, se jemi goxha moti në këto farë procesesh. Sidoqoftë....

Asnjëherë s'e kemi bërë. Asnjëherë s'e kemi bërë se s'kemi pasur nevojë që ta bëjmë. Më së paku, më së paku, më së paku Vetëvendosja e ka përkrahur kushdo që ka qenë në pushtet. Asnjëherë si opozitë s'e ka përkrahur dhe s'ka qenë përkrahëse.

Sidoqoftë, befasohem, znj. kryetare, mua më vjen shumë keq, kemi dallime politike, por kjo përtej dallimeve politike është edhe aspekti njerëzor.

KRYETARJA: Faleminderit! Një sqarim. Ne e kishim një marrëveshje me të gjithë deputetët që të kthehemi në sallë në orën 17:20. Që nga ora 17:20 deri në orën 17:45 ka rënë zilja, plot 25 minuta.

Kemi kërkuar që administrata të shikojë se kush është prapa te bufeja dhe t'i thërrasë deputetët dhe e kanë bërë një gjë të tillë. Në fund në orën 17:45 d.m.th. plot 25 minuta pas kohës së caktuar, meqenëse ishin 64 deputetët në sallë, ka qenë kërkesë e deputetëve, ashtu siç parashihet edhe në Rregullore që seanca të vazhdojë në momentin kur ka kuorum.

Meqenëse nuk kishte as të lajmëruar për debat e as kërkesa të tjera, e vetmja çështje që kishte mbetur për t'u trajtuar, ishte votimi.

Zoti Hamza, unë dua t'ju falënderoj juve për korrektësinë që e keni treguar në takimin që e patëm, por ju tregoj shumë sinqerisht përshtypja jonë ishte që ju vet nuk po doni të vini, përkundër 25 minutat e ziles edhe përkundër faktit që u përmend ora e saktë, pra 17:20 kur fillojmë.

Kështu që, besoj që nuk do duhej ta trajtonit këtë si diçka tjetër, po thjesht si procedurë të cilën unë kam qenë e detyruar që ta respektoj, edhe është kërkesë e deputetëve që në momentin kur janë 61 në sallë që të procedohet për shkak të pritjes së gjatë. Po jua jap fjalën meqenëse edhe ua përmenda emrin.

BEDRI HAMZA: Faleminderit, kryetare!

Faleminderit kryetare, por zoti Selimi ma di numrin e telefonit edhe më ka thirrur. Jo, jo, të lutem! Të lutem! Jo, jo e dini mënyrën e komunikimit, mirëpo, prano, zonja kryetare, unë po të isha në vendin tënd, e kisha pranuar, të paktën kisha ndër shumë keqardhje po ta kisha bërë të njëjtën situatë unë ty sikur që ju më keni nxjerrë në pozitë mua. Ju votojeni buxhetin, votojeni, në rregull është, veç mos u thirrni as në rend, as në ligj, as në procedurë, as në transparencë, as njerëzillëk. Por, këtë që po e them, nuk kam qenë veç unë në tavolinë, kemi qenë një numër i konsiderueshëm i njerëzve dhe qëllimi ka qenë që në këtë situatë të ofrohet rrugëdalje, jo të bllokohet në asnjë formë. Si opozitë nuk kemi qenë të interesuar ta bllokojmë vendin, pavarësisht që është rol i opozitës t'i kryejë punët e veta, por ne nuk kemi qenë të interesuar në asnjë formë, se përndryshe fare s'kishim ardhur zonja kryetare te ti në zyrë, të kishim thënë: "O, tërhiqe mocionin, o qite në votim", kaq.

Edhe, s'kishe mundur ta kaloni, e ke ditur që s'ke mundur ta kalosh. Sidoqoftë, gjithkush e ka stilin e vet të jetës, të punës, i ka rregullat e veta dhe vazhdon të jetojë me to.

KRYETARJA: Faleminderit! Unë vërtet do të ndihesha keq sikur ta bëja një gjë të tillë me qëllim, por meqenëse nuk e kam bërë, nuk mund ta pranoj. Poenta është kjo, ne e patëm një orë të caktuar dhe përshtypja ime vërtet ishte që ju personalisht nuk keni ndonjë qëllim ta bllokoni shtetin dhe vërtet e pashë mospraninë tuaj si një ndihmë në këtë aspekt. Ashtu edhe e lexova unë, si ndihmë dhe jo si qëllim bllokimi, ky ishte interpretimi im së paku. Faleminderit! Fjalën nga Grupi Parlamentar i AAK-së, kush e dëshiron fjalën? Daut Haradinaj, urdhëro!

DAUT HARADINAJ: Kryetare, faleminderit!

I kam do miq këtu në sallë, i kam njohur për burra, por që janë mashtrues ordiner, si Rexhep Selimi, e kam ditur, por që je kaq, bravo të qoftë, bashkë me kolegun tënd që ishte prezent.

Edhe, nuk bëtë mirë hiç me këtë sjellje që e bëtë se nuk pati kurrkush vullnet ta bllokojë, por pati vullnet t'ju përkrahë, nën një. Në dy, kryetare, jeni dakorduar pas mbledhjes së Kryesisë dhe shefave të grupeve t'ua tregojnë anëtarëve të grupeve parlamentare të shihemi prapë. Pse nuk i thirre? Ke pasur edhe një herë të takohesh me ta dhe ta gjesh një zgjidhje, pse ishim pro një zgjidhjeje. Që jeni amatorë në Qeveri, kjo dihet, se po shiheni, por mos u fshihni pas coronavirusit, se nuk është ajo arsye sot që jeni këtu, e dini më mirë se unë. Nuk keni afate ligjore për buxhet dhe për këtë arsye e bëtë këtë sjellje. Mendoj që do t'u duhemi prapë në të ardhmen, këtë mbajeni në mend dhe këtu do të jemi.

Mos i humbni miqtë, se ju duhen, edhe këtë dijeni, se për mik njeriu hyn në zjarr nganjëherë, lëre më që ne numrat e dimë që i keni dhe s'keni pasur nevojë të bëni këso fiskulturash. Kryetare, prej fillimit kur e mora fjalën, u mundova të them që është masakruar buxheti dhe nuk prita që të ketë nevojë për debat rreth kësaj pune, por se do të na jepni kohë që t'i bëjmë amendamentet për

projekte të caktuara, i bindur që edhe kryeministri, edhe ministrat, edhe partitë politike në pushtet e kanë në interes vital infrastrukturën në Kosovë, sidomos ato projekte, të cilat janë nisur qysh në Qeverinë e Isa Mustafës. E kemi zëvendëskryeministrin këtu, i di më mirë se unë dhe po ashtu, që kanë vazhduar dhe që në këtë rast pothuajse janë sakatuar krejt. E kemi, po filloj me Obiliqin, dy projekte kryesore. Është termocentrali Kosova B, ndriçimi 235 mijë euro është i hequr, e kemi rrugën “Avni Rrustemi” në Obiliq të hequr, në Milloshevë të hequr, i kemi 280 mijë euro projekti i paraparë për Hade, Shipitullë i hequr, janë edhe nja 4-5 projekte të vogla, të cilat nuk po i cek, por që e kanë vlerën 70-80 mijë euro.

E keni Gjakovën skajshmërisht pa asnjë kursim, shpresoj që dikush po na dëgjon. Vetëm qarkorja e rrethit ku është rruga “Bujar Roga” është 800 mijë euro, është hequr. E ke rrugën Gjakovë - Dollc, në vlerë 4 milionë euro ka qenë, është 20 mijë euro. Me matematikën time përafërsisht nevojiten vjet për t’u kryer kjo rrugë. E keni stadiumin e qytetit të Gjakovës, ministrja më përmirësoi, tha i kemi ndarë 200 mijë euro, jo 100 mijë. Projekti ka qenë i paraparë në vlerë 9 milionë euro. Ky projekt, garant Mimosë, kur të pensionohesh do të kryhet. E keni rrugën dalje për Prizren, e hequr krejt, e keni zgjerimin e rrugës në drejtim të Deçanit, e hequr krejt, rrugën Jabllanicë - Cërmjan..., e hequr krejt, s’do të kryhet kurrë.

E keni drejtimin e Prizrenit të hequr krejt, e keni Rahovecin po ashtu, vetëm në komunën e Rahovecit, brenda në qytet janë hequr 1 milion e 145 mijë euro, të mos i numëroj projektet që shumica e tyre janë direkt në infrastrukturë të fshatrave. Nuk është paraparë fondi për përkrahjen e njerëzve që janë dëmtuar nga reshjet, por gjithsej i keni 1 milion e 145 mijë euro të hequra një komune. Pak ka komuna që nuk janë hequr mjetet, pak ka infrastrukturë e projekte kapitale që nuk janë larguar pothuajse tërësisht. Edhe një herë po e përsëris, okej, keni vendosur për autostradën e Dukagjinit, keni thënë se është shtrenjtë a është lirë, se do ta bëni katërtrakeshe, do të bëni zgjerim të rrugës, vlera po ju del e njëjtë, besa edhe më shumë me shpronësim, keni për të qenë dëshmitarë edhe ajo nuk është paraparë që të bëhet, vetëm fjalë.

Rrugën e Plavës, të mos e përsëris më, marre i qoftë kushdo që i ka hequr ato mjete, sepse në emër të këtyre patriotizmave keni ardhur deri këtu, po mirë që populli po ju sheh ku jeni, e keni sheshin qendror të Rahovecit të hequr krejt, Klinën më, të mos flasim, e keni Klinë - Shtupel projekt i hequr, projekti për furnizim të ujit të komunës së Klinës i hequr, asfaltimin e rrugës Zllakuqan - Leskoc i hequr, Gllarevë - Grabanicë - Shtupel - Volljakë i hequr, Qendrën Kulturore të Suharekës të hequr, shtëpinë e kulturës “Ukë Bytyqi” në vlerë 47 mijë euro, edhe kjo e hequr, ndërtimi i rrugës “Brigada 131” në Suharekë e hequr, rruga Gjerovicë - Junik e hequr, Qendrën e Deçanit e hequr, rrugët e infrastrukturës në regjionin e Pejës, pothuajse që shumica nuk janë hequr, por janë ulur çmimet. Krejt këto na bëjnë të besojmë që kjo qeveri më së paku e ka hall jetën e qytetarëve në Kosovë dhe shihet se ashtu qysh u kontrabandua kjo, ashtu është kontrabanduar edhe projektbuxheti dhe po jua them edhe një fjalë, kam besim edhe kam respekt për ministrin e Financave, i cili tha “asnjë projekt të vetëm nuk ua kam hequr ministrive”

që më bëri shumë përshtypje. Do të thotë, kryeministri ka rënë në lajthitje prej ministrave të caktuar, të cilët ia kanë hequr projektet vitale të Republikës së Kosovës.

Ligji për pagat nuk është në buxhet dhe kjo do të jetë një problem shumë i madh, këtu jemi, do të shihemi prapë. Nëse sot jemi kah ballafaqohemi me këtë krizë dhe janë mjekët, janë kategoritë e caktuara, policia, emergjenca, pikërisht këto kategori goditen me këtë ligj dhe nuk janë paraparë në këtë projektbuxhet. E thashë në fillim, të mos e përsëris, e kam këtu komplet dosjen e caktuar me të gjitha projektet që janë larguar, pata vullnet për ta përkrahur kalimin e projektbuxhetit, dhe t'i jap hapësirë integritit me anë të amandamentimeve të këtyre projekteve, por e thashë edhe një herë, njeri në besë prehet edhe është krejt normale kjo punë, sepse këtu dëshmohet kush është burrë e kush jo. Ia pafshi hajrin këtij projektbuxheti, por ky është buxhet i hajnisë të një ministrie të caktuar, kurrë një send më shumë. E, zoti kryeministër, ishalla i merr masat, se kështu qysh ia ke nisur, mozamakeq për ty. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Replikë Rexhep Selimi, edhe Mimoza Kusari pastaj.

REXHEP SELIMI: Unë për dallim prej Dautit, replikën time do ta kem pak më të qetë dhe pak më të koncentruar. Daut, janë dy gjëra që po të mungojnë momentalisht: e para, që po të mungon sot është vetëdija se në çfarë situatë është Kosova dhe qytetarët e Kosovës. Duhet të jeni shumë më të vetëdijshëm se nuk bëhet fjalë thjesht për gjëra të përditshme dhe të zakonshme, por për një situatë shumë të jashtëzakonshme. E dyta, që ka ndodhur jo shpesh, por të mungon edhe kultura e shprehjes. Nuk të shkon as për fytyrë ty e as për profilin tënd të shprehesh, ndonëse në momentin e caktuar mund të jesh pak edhe nervoz. E treta, ishe edhe i pasaktë, kjo nuk lidhet me dy të parat, ishe i pasaktë kur the ne patëm vullnet ta përkrahim, ne sapo u ndamë, ishim në korridor dhe ti nuk shprehe vullnet ta përkrahni sot propozimin tonë për procedura të shpejta. Prandaj, ju duhet ta kuptoni edhe një herë që në momentin kur po flasim, nuk e kemi komoditetin, e aq më tepër as sigurinë që Kuvendi i Kosovës mund të mbledhet sërish në procedura të rregullta për ta votuar projektbuxhetin. Nëse kërkoni që ne ta mbështesim, nëse kërkoni që ne t'i përgjigjemi situatës, atë nuk mund ta bëjmë pa buxhet, prandaj sot ju nuk keni qenë thjesht kundër kësaj seance, më shumë se që keni qenë kundër buxhetit.

KRYETARJA: Kundër-replikë, Daut Haradinaj!

DAUT HARADINAJ: Dola përballë edhe një herë që të shikoj në sy se po më vjen shumë mërzë kur po flet pas shpine. Për sa i përket fytyrës, edhe sa i përket kulturës mund të them që unë s'kam kulturë ta pres dikë (*në besë*), nuk kam kulturë jo të ikë prej atje në sallë në emër të kohës që e kërkuat. Nuk e pata atë kulturë, për këtë arsye thashë nuk kam vota për ty sot, sepse i keni shkatërruar amendamentet..., e keni shkatërruar thashë krejt komplet infrastrukturën e paraparë për ndërtim dhe pa fije fytyre ke ikur, ke ardhur në sallë dhe tash po flet. Mos fol hiç, thashë, "po hajde t'i japim votat, futeni në projektbuxhet autostradën e Dukagjinit, rrugën e Plavës".

KRYETARJA: Mimoza Kusari, replikë!

MIMOZA KUSARI-LILA: Daut, a të ngrihem në këmbë të këqyri drejt nëse do të mos flas pas shpine. Jo veç po të tregoj, jo, jo, duhet ta dish: si e para këtu ka burra dhe gra që e mbajnë fjalën, e nuk janë veç burra, ta kemi të sigurt këtë. Si e dyta, për qartësi edhe për korrektësi të informacionit, Qeveria Haradinaj prej vitit 2017 - 2019 komunës së Gjakovës ia ka hequr 19 milionë euro, Daut. Në mesin e tyre edhe projektet që po i kërkon të kthehen. Si e treta, Qeveria Kurti nuk ia ka hequr ato që ti po i përmend, është rishqyrtim, në fakt, është ndarje e cila në disa raste nuk ka mundur të shpenzohen në vitin 2019 kur ka qenë Qeveria Haradinaj. Rasti i Qarkores dhe hyrje-daljes të Pejës dhe Prizrenit. Projekti ka qenë me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim 23 milionë euro. Daut, si ka ardhur Ardian Gjini kryetar, e ka hequr prej Bankës Evropiane dhe e ka vendosur në buxhet të Ministrisë së Infrastrukturës për arsye që ta nxjerrë tenderin vetë. E arsyet pse duhet publikuar tenderin vetë e jo Banka Evropiane i dini ju, jo unë.

Edhe prej 23 milionëve në qeverinë tuaj ka rënë buxheti në 8 milionë, e i keni buxhetuar veç 6. E njëjta është edhe për stadiumin, stadiumi është 900 mijë euro, për korrektësi, jo 9 milionë, edhe e para, edhe vitin e kaluar asnjë cent s'e keni investuar, sivjet janë paraparë të investohen 200 mijë. Mos shpërndani megjull në një situatë ku ne nuk e dimë nesër si do të na zbardhë dita, sot e ke një deputete mangu, për arsye se është e izoluar në zonë që ka virus, nesër nuk e dimë sa deputetë mund t'i kemi, e sot të bëhet pazar e të mundohesh të nxirren këto amendamente, në situatë kur vendi nesër kalon në situatë emergjente, nuk është as e drejtë e burrave, e as e grave, se bashkërisht jemi këtu, e s'jemi veç e veç. Faleminderit!

KRYETARJA: Kundër-replikë, Daut Haradinaj!

DAUT HARADINAJ: Faleminderit!

E di që ka, bile po shihet që më shumë po e mbajnë fjalën gratë se burrat. Pajtohem me ty plotësisht për këtë pikë edhe ju përgëzoj. Isha duke folur rreth infrastrukturës në Gjakovë dhe goditjeve që iu kanë bërë infrastrukturës. Nëse dikujt ende s'i ka kaluar temperatura e humbjes, çka të bëj unë, kështu një herë njëfarë vakti na kanë mundur, e ka mundur Ardiani, edhe Ardiani s'është i përjetshëm, Gjakova është e përjetshme dhe për këtë arsye jemi në demokraci, kryetare, megjithatë unë kam respekt për ty. Sido që të jetë, lufto të nxjerrësh diçka në Gjakovë se kanë nevojë shumë.

KRYETARJA: Nga Nisma, Fatmir Limaj!

FATMIR LIMAJ: E nderuar kryetare e Kuvendit!

Ajo që ndodhi sot, besoj duhet shqetësuar dhe është mirë të shqetësohen njerëzit e pjekur, njerëz që duan unitetin, që duan e që kanë nevojë për njëri-tjetrin. Unë kam besuar dhe besoj shumë që

ky Parlament ka njerëz të pjekur e kjo qeveri që nuk do ta lejonte të bëhej kjo aventurë që ndodhi sot. Sot, ju thirrët për të ndërtuar qëndrim të përbashkët, ju thirrët qëndrim të përbashkët dhe në situata të tilla Parlamenti i Kosovës ka ndodhur, nuk është hera e parë ky Parlament kur është thirrur në situata të tilla për të ndërtuar një qëndrim të përbashkët, pastaj njoftohen grupet për t'u kthyer në seancë dhe kanë arritur apo s'e kanë arritur qëndrimin. Kjo çka bëtë sot, thjesht keni futur një virus, pasi që jemi te virusi, një virus të përçarjes, do ta shihni, Kujtim, ky është një virus i përçarjes dhe e keni humbur mundësinë, minimumin që u tha të një bashkëpunimi të mundshëm.

Kjo tregon se fjala për bashkëpunim, koordinim është përrallë e atyre, të cilët nuk e dinë çka është bashkëpunimi, nuk dinë çka është uniteti, çka është koordinimi, nuk dinë çka është nevoja për tjetrin. Sot, mendoj janë lënduar shumë, sot votohet buxheti, por është lënduar diçka që duhet kohë shumë për ta shëruar, bashkëpunimi pozitiv–opozitiv që është shumë i nevojshëm. Në këtë mënyrë, unë nuk e kuptoj se si keni lejuar, pavarësisht aventurave të individëve, si keni lejuar kështu Parlamenti sot të dalë para qytetarëve, ju jeni përveç kryetare e Kuvendit që i takon një grupit duhet ruajtur një lloj bashkëpunimi dhe koordinimi mes pozitës dhe opozitës. Ata kanë ardhur sot në zyrën e juaj si kryetare e Kuvendit dhe ju nuk është dashur ta lejoni aventurën e tij pa e pasur konsultimin paraprak edhe të atyre që keni thirrur, të shefave të grupeve opozitare.

Shikoni, ka pasur kryetarë të kuvendeve në situata më të vështira dhe kanë ditur t'i ruajnë raportet mes shefave të grupeve parlamentare, sepse u janë dashur për bashkëpunim të mëtutjeshëm. Kjo sot, vlerësoni si ta doni, por unë besoj që sot keni bërë një gabim të madh dhe keni humbur mundësinë, nesër ju edhe si mazhorancë, më vjen keq, edhe nga pozita e kryetares së Kuvendit të thërrasësh dike në zyre për konsultim. Imagjinoni, nesër i thirrni përsëri në konsultim në zyrë shefat e grupeve parlamentare, përveç kësaj, ju sot ia keni marrë të drejtën me këtë mënyrë të trafikimit, ua keni marrë mundësinë deputetëve që në mënyrë profesionale të japin vërejtjet e tyre për buxhetin. Praktikisht sot një pjesë e madhe e qytetarëve të Kosovës nuk mund të dëgjojnë, nuk kanë mundësi t'i dëgjojnë vërejtjet nga deputetët që i kanë votuar ata, sepse janë të papërgatitur, sepse secili deputet këtu është i papërgatitur të flasë për buxhetin. Kjo për mendimin tim, ju kam thënë, po ia kapërceni Hashimit, qe kjo është t'ia kapërcesh Hashimit. Ky është trafikim, ky është buxhet i errësirës, kjo mënyrë e funksionimit nuk i çon gjërat përpara. Shikoni, sot ia keni shkelur të drejtat deputetit, ia keni humbur sigurinë deputetit të Parlamentit të Kosovës, e keni mbivotuar dhe keni bërë garë, garë të pandershme.

Nuk është njëjtë të bie zilja kur është pauzë, e tjetër gjë është të thërrasësh për të ndërtuar një konsensus. Pajtohem me ju plotësisht sikur të ishte një pauzë normale, ordinere, erdh kush erdh, vazhdon seanca, por sot ne i kemi ndërprerë punimet me shpresën të ndërtohet një qëndrim i përbashkët se si të dilet ndaj kësaj situate. Dhe, përgjegjësia juaj ka qenë që kurrqysh të mos fillojë seanca pa i njoftuar grupet parlamentare, për më tepër, ne kemi kërkuar, Grupi ynë Parlamentar ka telefonuar në zyrën tuaj, ju keni thënë se ju njoftojmë kur do të fillojë seanca,

verifikoni te Administrata. Po më vjen keq, të nderuar kolegë e miq, që keni lejuar e po lejoni të miratohet një buxhet kështu, për besë, po më vjen keq, kështu që po e mbyllni çdo derë të bashkëpunimit, nuk është rruga kjo. Buxhetin i keni votat ta votoni, ne deri tani bëmë përpjekje si të bëhen 4, 5 a 6 ditë dhe të ketë mundësi deputeti të flasë. Kjo ishte, bile sa dëgjova, ishte propozim i kryetares dhe unë e mbështeta në atë grupin ku ishim ne që duhet dhënë mundësi për 5-6 ditë të përfundojë në situatë të rregullt.

Kjo çka keni bërë ju sot, praktikisht edhe dëshirën tonë për ta ndërtuar njëfarë konsensusi për tema të ndryshme, ju po e shkatërroni. Ne ishim duke ardhur me një propozim për pesë ditë të përfundojë, kjo çka po ndodh sot, dëgjoni çka po ju them, kjo s'ka ndodhur asnjëherë në Parlamentin e Kosovës, kjo është prerje në besë, kjo është shkelje e të drejtës së deputetit, kjo është trafikim, të nderuar kolegë, kjo prish marrëdhëniet e bashkëpunimit në temat që na vijnë, dhe kjo gjë kështu çka ka ndodhur sot në Parlamentin e Kosovës, është e turpshme.

Po, zonja kryetare, nëse nesër i thirr shefat e grupit parlamentar të opozitës mos u çudit që nuk do të të përgjigjen. Mos lejo uljen e personalitetin tuaj këtu për aventurat e individëve, ju e mbani Parlamentin, duhet të na krijoni siguri të komunikimit, bashkëpunimit dhe të gjetjes së konsensusit në tema të ndryshme, kështu s' ka bërë as ish-kryeparlamentari Nexhat Daci, as Jakup Krasniqi, as Kolë Berisha e as Kadri Veseli, të cilët kanë qenë kryetarë Kuvendi. Kjo që ka ndodhur sot, për herë të parë po e shoh në Parlament të Kosovës. Votojeni, për 4-5 ditë të ndodhë kjo situatë, është e tmerrshme çka keni bërë sot. Nuk dëshiroj ta ofendoj askënd individualisht, kjo çka keni bërë ju sot, kjo e ka mbyllur çdo derë të bashkëpunimit të mëtutjeshëm pozitë-opozitë në temat që na vijnë. Kjo tregon që këtu jo që s'jeni të interesuar për bashkëpunim, por keni treguar sot që aty ku s'keni nevojë, i mshoni shkelëm, ia shkelni të drejtat njeriut. Sot, për shembull, ka zë opozitar, ka popull opozitar që do të dëgjojë deputetin opozitar çka mendon për buxhetin, e s'ka mundësi sot të flasë. Sot, asnjë deputet në opozitë dhe populli opozitar s'do të mund të dëgjojë çfarë vërejtje kemi, pse? Na e pamundësuar këtë.

Po ju thoni "flisni", por jo, ne s'jemi të përgatitur, se buxheti na ka ardhur dje. Sot drafti ka ardhur dhe është e papërgjegjshme, joprofesionale sot unë të flas për buxhetin kur e kam parë sot për herë të parë. Prandaj, kjo të mos i japë mundësinë deputetit ta kryejë detyrën e vet kushtetuese është shkelja më e madhe që po i bëhet në Parlamentin e Kosovës. Këtë nuk ka qenë dashur ta lejoni ta bëjë një zonjë e nderuar profesioniste, siç është kryetarja jonë e Kuvendit. Me asnjë çmim, me asnjë luftë politike kryetarja e Parlamentit, si profesioniste, kam qenë i bindur që kurrë nuk e lejon një gjë të tillë. Të na i shkelë mundësitë, shkelje ligjore është kjo. Domethënë, në një mënyrë është abuzim me atë 2/3, në mënyrën që keni bërë është abuzim i ligjit, abuzim me Rregulloren dhe është shkelja e të drejtave të deputetëve të Parlamentit të Kosovës. Po, ishit duke biseduar, kështu na thanë, nuk është pse nuk erdhët, kur të thirrur kryetarja e Kuvendit, mësojeni rregullën, kur i thërret kryetarja e Kuvendit në konsultim shefat e grupit parlamentar, nuk është sikur pauzë normale dhe, në fund kryetarja e Parlamentit e cila u orvat të gjejë një

konsensus, tregon që u arrit apo s'u arrit konsensusi dhe pastaj vazhdohet në procedura normale, pra kryetarja e Kuvendit duhet të thotë se u përpoqa dhe s'munda t'i ofroj, vazhdojmë në rrugë tjetër. Kjo ishte përgjegjësi e kryetares së Kuvendit që të mos lejojë të ndodhë kjo.

Sido që të jetë, doni të vazhdoni kështu, vazhdoni, por kjo çka ka ndodhur sot është e tmerrshme, i keni dhënë fund mundësisë së bashkëpunimit, ju shefat e grupit parlamentar qysh doni të flisni nesër me kolegët tuaj, shefat e grupeve parlamentare që të ndërtoni një konsensus. Nga sot jo, unë po ju them ne as nuk i përgjigjemi kryetares së Parlamentit të shkojmë për këso tema bashkë, unë po flas për Nismën, e as shefave të grupit parlamentar. Kjo mënyrë e komunikimit dhe bashkëpunimit është rrugaçëri, nuk është komunikim institucional. Dhe, ku ka ardhur, ne nuk marrim pjesë në asnjë variant, më zonja kryetare, me respektin e jashtëzakonshëm, ne nuk do t'i përgjigjemi asnjëherë ftesës suaj në orvatje të ndërtimit të konsensusit në mënyrë siç ka ndodhur. Faleminderit!

KRYETARJA: E ka kërkuar fjalën zoti Gashi dhe zoti Selimi si replikë, mirëpo më lejoni vetëm shkurt.

E para, kërkesa për 30 minuta pauzë për konsultime në grupe parlamentare nuk ka qenë kërkesë imja, por e grupeve parlamentare. Me kërkesë të opozitës që ta caktoj orën e saktë se kur rifillon kjo seancë, rrjedhimisht edhe i vazhdon punimet, unë kam përmendur orën 17:20. E treta, unë e kam parë mosprezencën tuaj, meqenëse mosprezenca dhe mospjesëmarrja në votim, e sqarova, si mundësi që po dëshironi t'u jepni deputetëve prezentë ta krijojnë 2/3 dhe pastaj të ktheheni për diskutim dhe debat për buxhetin, sepse debati nuk ndalet ashtu, siç po dëshmohet edhe tash. Zoti Limaj, situata nuk është normale, është e jashtëzakonshme. Përderisa ne po flasim këtu, shumica e Qendrave të Mjekësisë Familjareve, shumica e spitaleve punojnë në kushte të jashtëzakonshme.

Ne po flasim për komuna që nuk kanë as mjetet elementare ta trajtojnë këtë situatë të jashtëzakonshme, përderisa atyre nuk po u lejojmë t'iu miratohet buxheti që u duhet. Prandaj, nuk është asgjë normale sot, nuk është normale, por është e jashtëzakonshme, por ju siguroj që asnjë rregull nuk është shkelur, e aq më pak premtimi im që seancën e vazhdojmë në orën 17:20. Edhe nuk desha të trajtojmë çështje të tjera, por meqenëse i përmendët ish-kryeparlamentarët. Kur ne si opozitë kemi kërkuar me 40 nënshkrime seanca të jashtëzakonshme, ju as nuk e thirrnit seancën, edhe pse ne donim që të diskutonim për kufijtë, për mbrojtjen e kufijve të Kosovës, ju na thoshit bëhuni 61 në sallë, e tek ne pastaj vijmë.

Unë nuk sillem sikur ish-kryeparlamentari që nuk vinte ta udhëhiqte seancën e jashtëzakonshme, të kërkuar nga opozita për mbrojtje të kufijve. Sa herë të kërkonit seancë të jashtëzakonshme, unë do të vij këtu dhe do ta udhëheq atë seancë. Por, kur kemi situatë, jo nuk e keqpërdori, por po e përdor tamam qysh duhet për mbrojtje të interesave të qytetarëve, nuk dal aty në foltore se është

prekur prej shumë deputetëve dhe mund të infektohemi. Edhe e fundit, po e përsëris, unë isha e bindur dhe ia kam thënë këtë edhe nënkryetares së Kuvendit që qëllimi juaj, përkundër ziles për 25 minuta ka qenë që të mos vini për disa minuta derisa të kalohet mocioni dhe pastaj të na bashkoheni për debat. Ndoshta e kam keqinterpretuar, vërtet më vjen shumë keq për diçka të tillë, por kështu e kam besuar, sidomos pas diskutimeve që i kemi pasur me grupet parlamentare aty. Kjo është qysh e kam parë unë situatën. Urdhëro, në qoftë se dëshiron kundër-replikë. Zoti Limaj e ka fjalën!

FATMIR LIMAJ: S'jam i interesuar për kundër-replikë, por ajo çka po dua ta them, zonja kryetare, ne nuk mund ta mundim njëri-tjetrin me fjalë, se s'është koha me fjalë. Veprimin e shikoni, fjala-fjalën s'mund ta mund, ka lloj-lloj arsyesimesh. Unë këtu e kam parë qysh në ditën e parë të Parlamentit të Kosovës, ju edhe po mendoni për neve, edhe po na tregoni nëse keni ndonjë gjë të rëndësishme të flasin, ta themi, lërnani ne të mendojmë për veprimin tonë, mos mendoni për neve. Ju e dini si duhet të silleni, deputetët s'kanë qenë në Parlament, s'kanë qenë në sallë, Kryesia është dashur t'i ftojë, të vijnë, u pajtuam a s'u pajtuam. Unë nuk jam duke folur për temën, gjendje e jashtëzakonshme, ju po thoni është gjendje e jashtëzakonshme dhe ju s'jeni të gatshëm si Parlament të punoni çdo ditë të jashtëzakonshme.

Ju po thirrni te infermierët, pse ata po bëjnë punë atje në rrezik të drejtpërdrejtë nga virusi, e nga Parlamenti i Kosovës po doni të ikim. Pse të mos rrimë ne 2 javë ditë këtu, çdo ditë. Nëse po edhe policia, po rrinë mjekët, po rrinë infermierët, pse ne të mos qëndrojmë deri sa ka nevojë t'i përgjigjemi kësaj situatë të jashtëzakonshme, plus ju jeni kryetare e Kuvendit...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: Vazhdoja fjalën, të lutem, zotit Limaj!

FATMIR LIMAJ: Faleminderit, kryetare! Po them gjendjen e jashtëzakonshme ju e dini se si shpallet. Shpalleni, pra gjendje të jashtëzakonshme në qoftë se është. Ajo që po dua të them, Kuvendi i Kosovës duhet të jetë në punimet e përditshme sikur që janë të tjerët, krijohen kushtet për të pasur punime të përditshme, por po them, fjala-fjalën s'e mund, ajo që unë po them e po shqetësohem është kjo, është lënduar një mundësi e një bashkëpunimi në temat që vijnë, e unë nuk dua ta shoh Parlamentin e vendit tim në këtë situatë çfarë jemi sot.

Dhe, mua më vjen keq dhe kërkoj falje për ndonjë fjalë të pavend që më ka dalë ose del, por ajo çka po dua të them, shqetësimi që po paraqes është detyra juaj edhe e neve bashkë që të punojmë, të gjejmë rrugë të bashkëpunimit dhe koordinimit në tema të rëndësishme nacionale. Kjo e sodit çka ka ndodhur ta flitet jo 2 minuta, 3, 10 minuta, por ju e dini, sikur që e di unë, kanë lënduar aq shumë raportet dhe e ka thelluar aq shumë mosbesimin që vështirë do ta kemi më ne

të ndërtojmë raporte kredibilitete t'i ftojme grupet parlamentare për qëndrime të përbashkëta dhe ky është shqetësimi im.

KRYETARJA: Po, po e them sërish që nuk ka qenë qëllimi aspak aty, në qoftë se është keqinterpretuar, shpresoj do të kemi mundësi ta sqarojmë.

Nënkryetari i Kuvendit, Kujtim Shala, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, në emër të vetin, replikë. Në rregull!

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar kolegë,

Zoti Limaj, unë nuk kam qenë pjesë e këtij procesi, asnjë komunikimi formal ose joformal dhe kjo domethënë që unë nuk kam asnjë lidhje me këtë punë, kështu që ju m'u drejtuar pa lidhje.

KRYETARJA: A do të dëshironit kundër-replikë, zoti Limaj? Po, zoti Limaj e ka fjalën një minutë.

FATMIR LIMAJ: Po, unë besoj i nderuar zoti Shala, po të ishe ti, s'do të kishte ndodhur kjo që ndodhi, por reagimi im ishte i stilit, ti e di që ne e kemi një farë stili të komunikimit kështu. Që unë jam i bindur që s'kishte ndodhur kjo. Ajo që po dua të them, zonja kryetare, me keqardhje ne do të jemi të detyruar të dalim nga salla, sepse na u ka pamundësuar dhënia e qëndrimeve, e mendimeve, diskutimeve rreth buxhetit, sepse nuk jemi të përgatitur për këtë temë. Na pamundësuar kontributin tonë rreth këtij buxheti. Sot, ajo që e thashë, fatkeqësisht ky është një lloj trafikimi që nuk i ka hije Parlamentit të Kosovës të ndodhë.

Edhe, atë që e thatë më herët, por për atë kemi dashur ta bëjmë pak më mirë dhe ju e dini që unë kam qenë ithtari për ta bërë më mirë, ju personalisht e dini që të mos paraqiten këto situata, unë shpresoj që deputetët këtu, disa prej të cilëve kemi kaluar situata më të vështira...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: Faleminderit! Arben Gashi ka replikë.

ARBEN GASHI: E nderuar kryetare!

Kolegë deputetë,

Meqenëse unë isha pjesë e një diskutimi në zyrat e kryetares, më duhet, nëse jeni dakord edhe detajet t'i diskutojmë, por për hir të korrektësisë më duhet të them që përfaqësuesi i AAK-së dhe përfaqësuesi i Nismës as nuk kanë treguar gatishmëri për të gjetur zgjidhje, e para.

Më vjen keq prej përfaqësuesit të PDK-së, i cili ka qenë korrekt dhe ka ofruar mundësinë e gjetjes së një zgjidhjeje, pa premtuar për zgjidhje. Unë në bisedim ju kam thënë: “A jeni të gatshëm që para datës 20 për të gjetur një zgjidhje që ta mbajmë seancën?”, askush nuk ka premtuar që është i gatshëm ta gjejnë këtë zgjidhje. Përfaqësuesi i PDK-së ka thënë që çështja është se duhet marrë vendim në grupin parlamentar, unë e kam përshtypjen që e ka pasur sinqerisht angazhimin e vet dhe më vjen shumë keq nëse ai ka dashur të vijë në mbledhjen e lënë në orën fiks 17:20 te kryetarja, ku unë kam qenë, kam pritur deri në 17:30, nuk ka ardhur askush dhe kjo është situata që ka ndodhur aty.

Pra, për hir të korrektësisë dhe asaj që është diskutuar këtu, ne kemi lënë orë fikse për mbledhje te kryetarja për ta diskutuar këtë çështje dhe mbledhja ka qenë në 17:20, unë kam qenë prezent, nuk ka ardhur askush. Jam kthyer në sallë 17:30, nuk ka qenë kurrkush deri në orën 17:45. Pra, kjo është e vërteta që ka ndodhur aty, ka pasur prej përfaqësuesit të PDK-së një vullnet pozitiv që ai të tentojë të gjejnë një zgjidhje nëpërmjet grupit të vet parlamentar. Ndërsa, përfaqësuesit e tjerë as nuk kanë treguar gatishmëri për këtë punë, kjo është e vërteta, zoti Limaj. Ju fjalimin e keni të mirë, por e vërteta është ndryshe dhe nuk ka pasur marrëveshje për këtë çështje. Faleminderit!

KRYETARJA: Meqenëse i ka përmendur emrat, Bedri Hamza, replikë një herë, pastaj edhe me zotin Limaj, dhe të tjerët që kanë qenë prezentë.

BEDRI HAMZA: Jo, më së paku jam i interesuar për replikë, por veç për sqarim. Unë kam dhënë edhe propozim konkret, ju keni qenë aty, kam qenë shumë i interesuar të ofrojmë zgjidhje adekuate për situatën nëpër vend. Po, po. Jo, ka pasur propozim konkret, qysh s’ka pasur propozim konkret, që të arrijmë shqyrtimin në lexim të parë, t’i kenë pak ditë deputetët në dispozicion për të diskutuar amendamentet dhe brenda një periudhe shumë të shkurtër kohore të kthehemi në lexim të dytë.

Kemi diskutuar që edhe si opsion, pra po e hap krejt, kemi diskutuar si opsion që edhe seanca sonte fare të mos mbyllet, por të vazhdojë e njëjta seancë ditën e hënë ose të martë. Edhe ky ka qenë diskutim aty, dhe nuk po dua t’i diskutoj detajet më shumë, por ka qenë marrëveshja kjo. Do të thotë, ka qenë një atmosferë pune në atë takim që ka ndodhur aty, kemi kërkuar një kohë të shkojmë në diskutim në grupe parlamentare dhe jemi dakorduar që të kthehemi në kryesi të merremi vesh cili është qëndrimi jonë për të mundur të procedohet tutje. Sikur qëndrimi ynë të kishte qenë negativ dhe ne të kishim qenë në sallë, atëherë s’kishte mundur të ndodhë votimi, ajo ka qenë shumë e qartë, kjo është punë matematike.

Prandaj, ju kisha lutur shumë për korrektësi, do të thotë as s’kemi pasur kërkesë, as s’kemi pasur pengesë, as s’kemi nxjerrë kushte, as s’kemi diskutuar asgjë për kushtet qysh të procedojmë tutje, por kemi biseduar qysh ta gjejnë një zgjidhje optimale të përshtatshme për neve pozitën

dhe opozitën, por mbi të gjithë deputetët të kenë mundësinë në dispozicion, të paktën 2-3 ditë, t'i shfletojnë rreth 600-700 faqe material. Kaq ka qenë.

KRYETARJA: Kundër-replikë, Arben Gashi!

ARBEN GASHI: Faleminderit! E përsëris edhe një herë, unë kam vërejtur, kam pasur përshtypjen e angazhimit vullnetmirë të zotit Hamza dhe nuk e kontestoj, por në të njëjtën kohë unë kam pasur një pyetje specifike dhe dëshmitar jeni të gjithë, besoj dhe zoti Hamza e konfirmon: a jeni të mbajmë seancë që ta kryejmë buxhetin para datës 20, apo doni ta lëmë në afate ligjore? Nuk kam marrë përgjigje konkrete. Unë e kam bërë këtë pyetje konkrete, nëse nuk doni marrëveshje, propozoni kur doni datë, përndryshe shkojmë në seancë dhe tregojmë që ne kemi gabuar, bile unë kam përdorur këtë shprehje, kemi gabuar si Qeveri që nuk e kemi sjellë në kohë të duhur buxhetin, ndërsa gabimi i përbashkët, faji i përbashkët është që po e lëmë në kohë të krizës emergjente të coronavirusit, po e lëmë vendin pa buxhet dhe pa zgjidhje, këtë jua kam thënë brenda në sallë, këtë po jua them edhe këtu dhe besoj që të gjithë jemi dakord dhe e pranon edhe zoti Hamza dhe të gjithë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: Në emër të AAK-së, zonja Teuta Haxhiu, pastaj edhe zoti Limaj, replikë Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Jo replikë, kryetare, por po dua ta shpreh mendimin tim, nuk është replikë, por po i shfrytëzoj minutat e mi. Kam qenë në takim dhe ajo që sot u instalua, kryetare, ju keni rënë në ndikimin e kujtdo qoftë, edhe të deputetëve apo edhe të ministrit që me nguti e nuk ka ditur çka ka bërë në buxhet, ju sot keni instaluar një situatë të jashtëzakonshme që është shumë e keqe, ju jeni kryetare jo vetëm e pozitës, por e të gjithë deputetëve të Parlamentit të Republikës së Kosovës. Prandaj, me mirëkuptimin më të madh erdhëm në takim, propozimin që e dha kryetari i Grupit Parlamentar, zoti Hamza, ishte ky. Pra, çdo mundësi që të shkojmë në procedura të rregullta, në të kundërtën ajo që u propozua edhe prej sekretarit, seanca nuk mbyllet ose të tërhiqet mocioni ose të dilet në votim.

Ju tradhtuat, ngase ne po të donim të mos vinim, e kishim shprehur aty, por në propozimin e zotit Hamza ne u kthyem ashtu siç u dakorduar në grupet parlamentare, nuk është specifikuar koha, kemi thënë për afërsisht 30 minuta, por kemi pasur të kthehemi edhe një herë dhe ne nuk kemi marrë asnjë thirrje, sado që nuk janë 5 metra prej grupit parlamentar, secili grup parlamentar e ka zyrën e vet për të ardhur deri këtu. Ne kemi ardhur, por ju keni instaluar një gjë të jashtëzakonshme dhe tendenca për t'i ikur situatës së jashtëzakonshme me coronavirus fare nuk jeni marrë me atë punë, sepse gatishmëria jonë ishte që nga fillimi, pra gatishmëria edhe e Grupit tonë Parlamentar ishte që në këtë çështje të jashtëzakonshme për shkak të coronavirusit të

merremi seriozisht dhe ju nuk ishit seriozë në asnjë moment, por gjithmonë kontrabanduat, tentuat ta kontrabandoni, ashtu siç edhe ndodhi.

Josinqeriteti i fjalëve këtu, zoti Gashi, në atë takim ju keni thënë “a jeni me e krye buxhetin deri më 20”, unë thashë “kurdo që të thirremi në seancë, ne vijmë”, por buxhetin ju takon juve, si kërkon prej opozitës që ta kalojë buxhetin dhe, për më tepër, kur në Ligjin për pagat nuk keni planifikuar fare buxhet, e që të gjitha ato kategori presin, pra këtë ligj ju po paragjykoni edhe vendimin që mund të vijë nga Gjykata Kushtetuese. Mbi të gjitha, sa i përket asaj që tha Mimoza, Mimozë bre, sinqerisht po më vjen keq, po ti ke marrë vendim në Kuvend që me taksat e qytetarëve të Komunës së Gjakovës ata t’i paguajnë hyrje-daljet e qytetit të Gjakovës. Kjo ka qenë, dhe kjo është, kurse Ardian Gjini e ka hequr atë barrë mbi supet e qytetarëve, sepse në fund të fundit, edhe qytetarët e Gjakovës janë qytetarë të kësaj Republike dhe janë taksapagues sikur çdo qytetar i secilës komunë dhe e vetmja komunë në Republikën e Kosovës në kohën tuaj ka qenë që ata të paguajnë kredi, këtë barrë e ka hequr Kuvendi, e ka hequr kryetari Gjini me të drejtë, ngase ka qenë barrë shumë e rëndë për qytetarët që ata të paguajnë taksa, pra prej xhepit të tyre të paguajnë atë që ti ke instaluar, kredi.

Ma thuaj një shembull, në cilën komunë të Republikës së Kosovës ka pasur një shembull të tillë. I vetmi shembull ka qenë ky që ti ke dashur t’i ndëshkosh qytetarët e komunës së Gjakovës dhe atë ndëshkim e ka hequr Kuvendi i Komunës së Gjakovës, njëkohësisht kryetari Gjini. Kjo është realiteti dhe normal me të drejtë hyrje-daljet janë faturuar në buxhet, sepse buxheti është i të gjithëve dhe tani sa ka dalë buxhet, ajo është çështje tjetër. Unë vetëm se po dua të them për herë të parë në qytetin e Gjakovës i kemi gjashtë deputetë, kjo është e tmerrshme, gjashtë deputetë: Agoni, ti, Arbëria, Kokaj, unë, ish-ministri Pali, gjashtë deputetë ka komuna e Gjakovës, kurrë buxhet nuk ka pasur më pak. Çka thua sot ti, Mimozë, edhe secili për gjithë atë nëse me 100 mijë euro kryhet Stadiumi i Gjakovës, i Vllaznimit, unë nuk e di, nuk jam eksperte, por ndoshta mund të na e sqarojë dikush.

Të mos flasim për çdo projekt të hequr, pra për secilin projekt, me të cilët keni luajtur dhe i keni masakruar dhe, në fund të fundit janë qytetarët ata që vendosin për ne, normalisht në fund të fundit do t’i mbajmë përgjegjës, por barra më e rëndë që i ka shkaktuar kjo qeveri qytetarëve të kësaj komune, ngase edhe komunat e tjera janë, janë pikërisht në këtë kohë kur ka deputetë më së shumti. Ajo që duhet të përmendet, pra edhe një herë për të mos iu kthyer asaj që e thamë në fillim, po të ishim ne që nuk do të ktheheshim në sallë pa asnjë problem se, në fund të fundit, jemi opozitë, por sinqeriteti ishte. Sot, me propozimet që dha deputeti, shefi i Grupit Parlamentar të PDK-së, ne ishim të pajtimit dhe pritëm, ndodhi me shpejtësi, urdhëroni, i keni numrat, kaloni. Për buxhet ne nuk e kemi fare problem, problemin ne e kemi pse nuk ka buxhet të planifikuar për Ligjin për pagat, pse nuk ka buxhet për projektet, të cilat janë planifikuar dhe janë hequr mjetet. Të tërhiqen mjetet prej projekteve që kanë qenë të planifikuara, kjo nuk do të duhej të ndodhte në asnjë qeveri, cilando qeveri qoftë.

Por, të tërhiqen komplet dhe të mbetet pa mjete cilido projekt dhe, në fund të fundit rruga Gjakovë - Klinë nëse çdo ditë udhëtojmë andej, secili prej nesh, edhe qytetarët, mund të kenë aksidente të ndryshme, fatmirësisht në këtë kohë dimri nuk ka qenë ndoshta me borë të madhe apo ngrica, por aksidentet janë më shumë se sa të pranishme që mund të jenë në atë terren, atëherë kujt i bie përgjegjësia nëse ajo nuk përfundon në gjendjen çfarë është. Të mos flasim për secilin projekt dhe, në fund të fundit, nëse ju e vlerësoni, ju deputetët e Gjakovës nëse e vlerësoni që është e drejtë, atëherë le të mbetet ajo që ta vlerësojnë qytetarët. Ndoshta ishte dashur dyfish më shumë se sa në Qeverinë Haradinaj sot të ketë Gjakova, ngase ka deputetë më shumë.

Unë nuk po dua të diskutoj atë punë, por edhe një herë, kryetare, edhe pse ke shkuar sinqerisht më vjen keq që ke rënë në lajthitje, edhe ajo që Kryeministri Kurti e ka thënë shpesh, të zgërdhieni është keq, e unë e pashë shumë sot, ngase nuk është kjo lojë pingpongu, sepse kështu ju reaguat, mirëpo normalisht se e tradhtuat dhe në fund të fundit, ne nuk patëm çka të humbim, por e shprehëm gatishmërinë për të kaluar në faza, ngase edhe vetë deputetët, edhe Gashi e pranoi që ministri s'ka qenë kurrkund, ministri i Financave në takim tha u vonua, tha se bash kurrkund s'ka qenë derisa ka përpiluar buxhetin. Është fakt, mirëpo u vonua edhe me program që shumë më shumë se gjashtë javë kryeministri ka thënë do ta keni në ueb faqe, para dy dite ka ardhur programi, jeni vonuar gjithkund, por në mesin e kësaj vonese edhe po mashtroni, ama të mashtroni mbi të gjitha në dëm të qytetarëve, se në dëm të deputetëve le të jetë ajo, dhe në fund të fundit nuk është problem, por kjo vërtet ishte diçka e instaluar jo e mirë që nuk do të duhej të ndodhte. Prandaj, po mbeti diskutabile edhe kohën në të tjera takime kur kryetarja mund të na thërrasë si grupe parlamentare, atëherë normalisht se do të vendosim, edhe ne sikur të tjerët, se a do t'i përgjigjemi kërkesës së kryetares, apo jo.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Arbërie Nagavci.)

KRYESUESJA: Për replikë e ka kërkuar fjalën deputeti Arben Gashi, pastaj Mimoza Kusari-Lila dhe Agon Batusha.

ARBEN GASHI: Faleminderit, e nderuar kryesuese!

E falënderoj zonjën Haxhiu për konfirmimin e faktit se ajo në emër të subjektit të vet ka treguar mosgatishmërinë që të merren me çështjen e buxhetit, dhe po ashtu i konfirmoi dy gjëra: e para, që kemi pasur takim të saktë në orën 17:20 dhe unë kam qenë aty deri në 17:30 nuk ka ardhur askush, deri në 17:45 s'ka ardhur askush në seancë.

E dyta, është e vërtetë që unë kam thënë se ne si koalicion qeverisës bartim përgjegjësinë pse jemi vonuar me buxhetin, sepse në rrugë të rregullt buxhetore, buxhetit i bie që për herë të parë të trajtohet më 26 mars, leximi i parë, pastaj leximi i dytë normalisht i merr nja 2-3 javë dhe derisa 8 ditë kryetarja e Kuvendit dhe i bie në pjesën e dytë të prillit. Dhe, unë e kam marrë këtë përgjegjësi në emër të koalicionit dhe kam thënë që ministri nuk e ka llogaritur kohën mirë dhe

duhet marrë përgjegjësi për këtë punë, sepse sidomos kur e kemi fazën emergjente, është rrezik dhe ju kam thënë a jeni të gatshëm të vazhdojmë këtë betejë politike, kush i ka fajet, kush s'i ka fajet, a po duam të marrim veprime për situatën emergjente. Dhe, po e përsëris edhe një herë, i vetmi që ka treguar gatishmëri për të gjetur zgjidhje ka qenë zoti Bedri Hamza, i cili ka thënë për 10 minuta e kthej përgjigjen dhe në orën 17:20 takohemi përsëri. Nuk ka ardhur askush dhe është krijuar kjo situatë. Më vjen keq që ka ndodhur qysh ka ndodhur, më vjen keq vetëm për zotin Bedri Hamza, jo për të tjerët, kjo është e vërteta. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, zoti Gashi! Një minutë regjia, kundër-replikë.

TEUTA HAXHIU: Edhe një herë faleminderit, zoti Gashi, edhe një herë e konfirmoj që ministri i Financave s'ka qenë kurrkund kah e ka përpiluar buxhetin, kështu e ke thënë edhe në takim. Por, edhe një herë ke kërkuar mbajtjen e seancës për buxhet, kam thënë sa herë të na thirrni, ne vijmë, a buxhetin normalisht mos e kërkon prej opozitës, se nuk është praktikë. Orën fare nuk e diskutova, nuk e përmenda orën, kryetarja ka thënë do të kthehem prapë në takim, fjalët kanë qenë të kthehem edhe një herë në takim dhe kjo nuk ka ndodhur, e bëtë një veprim jokorrekt, por në fund të fundit, le të mbetet, thashë se nuk do të jetë vetëm sot Kuvendi, do të jetë edhe në të ardhmen.

Sa i përket korrektësisë, folëm, sa i përket buxhetit, çështje juaja, normalisht që ne i kemi fjalët tona, i kemi diskutimet tona dhe do të jemi këtu, por që të mbajmë përgjegjës, ju e thatë vazhdimisht që buxheti është vonuar me fajet e Qeverisë dhe të ministrit, prandaj po dihet, edhe ne po e dimë se nuk...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Fjalën për replikë për zonjën Kusari-Lila.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, nënkryetare!

Deputetes i them që kur ka kaq shumë zell të debatojë, kishte qenë mirë të kishte zell edhe të informohej si duhet. Tash, pasi që nuk po e kupton, po ia përsëris edhe një herë, Qeveria Haradinaj në vitin 2018 ia ka hequr 19 milionë euro buxhet Komunes së Gjakovës, viti i parë si kryeministër me sloganin "Tash Gjakova".

Në ato projektet e hequra kanë qenë: Shtëpia e Kulturës në Rogovë të Hasit, fushat e tenisit, shkolla fillore në Korenicë, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, të cilat janë kthyer mes dy leximeve me amendamentet që i kam propozuar, e para. E dyta, Qarkorja e Gjakovës ka qenë planifikuar të bëhet me nënhuazim, siç parashihet me Ligjin për financimin e këtyre projekteve në Kosovë, vlera ka qenë 23 milionë. Prej tyre 17 milionë kanë qenë të Ministrisë së Infrastrukturës të udhëhequr nga tash deputeti juaj asokohe, ndërsa 6 milionë me nënhuazim që

është dashur të financohet nga Komuna e Gjakovës. A kanë komunat e tjera projekte të tilla? Po, kanë! Ka Gjilani, Podujeva, Prishtina, ndërsa vetëm këtë vit Komuna e Prishtinës planifikon ta bëjë të njëjtën qarkoren e komunës me IBRD-në për arsye të ekspertizës edhe për arsye të formës se si i zhvillon Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim këto projekte. Arsyeja pse ju i keni hequr, jo për ta liruar qytetarin e komunës së Gjakovës, se sikur ta kishit pasur këtë qëllim nuk ia kishit lënë 5,6 milionë euro borxh, të cilat i kam trashëguar. Por, ka qenë për ta nxjerrë tenderin vetë dhe për t' i ndarë përqindjet në tender, sikur me gjithë projektet e tjera.

Komuna e Gjakovës nuk është e diskriminuar në këtë buxhet, në këtë kundërtën projektet që ju i keni paraparë dhe kanë qenë me 0 në vitin 2019, sivjet janë mjetet e ndara. Në listë të atyre që i keni lexuar të gjitha janë, buxheti është dokument publik dhe si i tillë edhe mund të konsultohet dhe të shikohet e jo të biem pre e manipulimeve.

KRYESUESJA: Një minutë, kundër-replikë.

TEUTA HAXHIU: Po, edhe një herë po ta përsëris se mashtrimet i ke zell. Ke tentuar t'ua lësh barrë kredi qytetarëve të komunës së Gjakovës ti, Mimozë, ta kemi hequr këtë mundësi, ua kemi hequr barrën që ua ke vendosur mbi supe qytetarëve, sa të ndahen përqindjet, Mimozë, ti e ke përvojën, e aty sigurisht e di, unë nuk e di, po ta dija, do ta thosha. Po, prej përvojës flet secili.

Dhe, sa për projekte normalisht se do t'i bëjmë të gjitha publike dhe do të dihet se sa ka buxhet në këtë Qeveri komuna e Gjakovës dhe sa ka pasur në kohën e zotit Haradinaj. Secilin projekt, Mimozë, e keni hequr, thashë gjashtë jemi, po ta përmend edhe ndërtimin e urës në Rugovë, asnjë cent nuk është në këtë vit. Për hyrje-daljet nuk kryhen as me 500 mijë euro, as me 200 mijë euro, po të kryheshin, unë do të kisha thënë urdhëroni, e votoj sot buxhetin ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Të nderuar kolegë deputetë, tashmë u konfirmua që janë edhe dy raste të reja të identifikuar me coronavirus, ju kisha lutur shumë që të qëndroni në temë edhe të vazhdojmë sipas rendit të proceduar.

Fjala është për shefin e Grupit Parlamentar të Grupit 6+, zotin Rasim Demiri, pastaj për përfaqësuesin e Qeverisë dhe kalojmë në votim. Faleminderit!

RASIM DEMIRI: Poštovana predsjedavajuća!

Poštovani premijeru Kurti,

Poštovani zamenici premijera, ministri,

Poštovani uvaženi poslanici,

Pored velike debate, eto došli smo i mi na red s Parlamentarni grupe 6+ da ukažemo na neke stvari, na jedno veliko nezadovoljstvo. Dakle danas govorim ispred Parlamentarne grupe 6+, to jest gde su predstavnici bošnjaka, turaka, roma i goranaca, da gospodine Premijeru, gospodine ministre, sa Budžetom koji smo tek danas dobili absolutno nismo zadovoljni. Međutim, svesni smo situacije kao što je predsjedavajuća upravo informisala da imamo još dva slučajeve koji su obolelih od ovog teškog gripa korone, tako da uzimajući u obzir sve te okolnosti, mi ćemo i pored toga što nismo zadovoljni kao bošnjačka, turska, romska i goranska zajednica sa budžetom koji je predviđen za 2020, pored toga podržati zbog ove urgentne stanje koje se dešava u našoj državi. Mada postoje dosta stvari koje su isto rizične, gospodine Premijeru, da vam ukažem na jednu stvar kao što je coronavirus, vi sigurno prolazite ka Rećanu, to jest put Prizren - Rećane, kao što je coronavirus opasna, toliko je taj put isto opasan za sve prolaznike, pa se bojim gospodine Premijeru i za vas i za nas sve, koji prolazimo tim putem koji svakim danom je od velikog rizika. I svi prolaznici koji prolaze tim putem su izloženi velikom rizikom, i zaista nije u redu da se taj projekt ne nađe u ovom budžetom, jer ugrožava život svih prolaznika koji prolaze.

Još jednom kažem, poštovani bošnjaci, turci, romi i goranci, koji smo vaši predstavnici, jeste da nismo zadovoljnih sa ovim budžetom, ali zbog stanja u kojem sada nalazimo, zbog ovog opasnog gripa, gripa korone, mi ćemo danas kao Parlamentarna grupa 6+ podržati budžet za 2020. godinu. Ali, u koordinaciji za premijerom Kurtijem, koji nam je dao čvrsto obećanje, sa gospodinom ministrom do rebalansa budžeta mi ćemo naše zahteve koji smo planirali za 2020. godinu završiti i realizovati uz obećanje Premijera. Zahvaljujem!

KRYESUESJA: Faleminderit, zoti Demiri! E ftoj përfaqësuesin e Qeverisë të marrë fjalën, zotit Bislimi.

MINISTRI BESNIK BISLIMI: Faleminderit!

Shkurtimisht, për disa prej brengave që u adresuan nga personat prezentë. Zoti Haradinaj, në adresimin tim në një moment tha që ka konstatime të ministrit të Financave që ai nuk e ka hequr as shtuar asnjë projekt, kjo është plotësisht e saktë, për arsye se kjo nuk është as detyrë imja të shtoj ose të heq projekte. Ajo çka ne kemi bërë si Ministri e Financave është t'u dërgojmë një qarkore të gjitha ministrive të linjës për arsye se, siç e thashë edhe në fjalimin e parë, ne nuk kemi mundur të intervenojmë te buxhetet komunale për shkak se ato kanë qenë të aprovuara nëpër asamblatë komunale. Andaj, edhe intervenimi ka qenë te ministritë e linjës dhe qarkorja që u kemi dërguar kryesisht ka pasur tri elemente: elementi i parë është obligimi i ministrive që në projektbuxhetin e tyre të përfshijnë obligimet e papaguara dhe të trashëguara. Ju rikujtoj që qeveria në ikje na ka lënë obligime të papaguara në masën e 328 milionë euro.

Kjo e ngushton hapësirën për manipulim të qeverisë së tanishme. Elementi i dytë në këtë qarkore ka të bëjë me trajtimin e projekteve të trashëguara, të cilat nuk kanë pasur shpenzime. Ne kemi identifikuar një numër të madh të projekteve kapitale, të cilat është dashur të fillojnë

implementimin në vitin 2019 ose në vitet paraprake dhe është supozuar të vazhdojnë edhe për vitin 2020, por që kanë pasur zero shpenzime në vitet paraprake. U kemi dhënë udhëzim ministrive të linjës që të jenë më fleksibile në vendimmarrje nëse duan të mbajnë apo jo këto projekte, meqë qartazi diçka ka qenë problematike me to. Për një pjesë të tyre ka dyshime se janë vendosur në buxhetin e vitit 2019 më shumë se premtime elektorale se sa si projekte të mirëplanifikuara. Ju informoj se bëhet fjalë për diku 184 projekte kapitale të tilla, me një vlerë të përgjithshëm prej 18.9 milionë euro. Këto janë disa nga projektet që u përmendën. Zoti Haradinaj e përmendi edhe projektin e Dukagjinit që tha se është tërhequr, unë nuk e kam gjetur një projektligj të tillë askund, projektin e autostradës së Dukagjinit, se nuk ka qenë i përfshirë, ka qenë veç manipulim i thjeshtë me qytetarët e Dukagjinit, qeveria e kaluar nuk e ka paraparë as edhe një euro për Autostradën e Dukagjinit.

Udhëzimi i dytë në qarkoren që kemi dërguar ka pasur të bëjë me korigjimin e numrit të stafit. Kemi parë një dallim të madh mes numrit të stafit të aprovuar dhe stafit aktual. Dallimi është marramendës, është diku 5 mijë pozita më pak janë të mbuluara se sa stafi i aprovuar, prej të cilave diku 2 mijë e 560 në nivel lokal, pjesa tjetër në nivelin qendror. Ajo që kemi bërë është që stafin e kemi bërë staf të aprovuar, mirëpo pastaj në bashkëpunim me ministrinë i kemi korigjuar në bazë të nevojave të tyre për rekrutime. Kërkesa e tretë që ka qenë në Qarkore ka pasur të bëjë me nevojën që të adresohet fakti që Qeveria është Qeveri e Kosovës, nuk është qeveri e rajoneve, rrjedhimisht edhe buxheti i Republikës së Kosovës duhet të jetë buxhet i Kosovës dhe jo i rajoneve. Dua të njoftoj edhe për këtë, në draftin e buxhetit që ka qenë i përgatitur nga Qeveria e kaluar kemi gjetur projekte kapitale për nivelin komunal, por me financim nga niveli qendror në masën e 145.9 milionë eurove. Konstatimi i shpejtë ka qenë që këto projekte janë përzgjedhur duke u bazuar në preferenca puro politike mes politikës në nivel qendror dhe atë lokal dhe duke mos zbatuar asnjë kriter, duke mos marrë parasysh asnjë specifikë të komunave. Shembull konkret është konstatuar që një komunë, për shembull, si Fushë Kosova, ka pasur financim nga niveli qendror në masën e 700 mijë eurove, ndërsa një komunë me popullsi të përafërt si Deçani ka pasur financim 9 milionë euro. Dallimi është 1 me 13.

Zoti Haradinaj tha: “Ardian Gjini është i përkohshëm, Gjakova është e përjetshme”, po zoti deputet, por edhe Fushë-Kosova është e përjetshme. Gjakova ka pasur 12 milionë financime nga qendra, Prizreni 6 milionë, edhe Prizreni është i përjetshëm, zoti deputet. Ne planifikojmë që këtë çështje ta zgjidhim në mënyrë sistemore dhe të qëndrueshme, duke futur në Ligjin e ri të financave të pushtetit lokal grantin e katërt për komuna, ku do të zbatohen kriteret e qarta, të drejta dhe transparente për financimin e projekteve në nivel lokal dhe me këtë do të hiqet diskrecioni i vendimmarrjes ad hoc edhe mbi preferencat politike. Një problem që dua të adresoj është që projektligji që kemi prezantuar sot në masën e mbi 90% edhe më tej pasqyron preferencat apo prioritetet e Qeverisë së kaluar. Nga 1 mijë e 82 projekte kapitale të listuara në tabelën 3.2. me një vlerë totale prej 435 milionë eurove, 899 sosh janë në një vlerë prej 390 milionë eurosh, janë projekte në vazhdim të bllokuara përmes kontratave të mëhershme. Nëse

përfaqësuesit e qeverisë së kaluar kanë qenë aq të zellshëm në bllokimin e buxheteve dhe hapësirave ndikuese në vitet për keqqeverisje të tyre do të ishte shumë e palogjikshme nëse sot me votë e kundërshtojmë këtë projekt të nënshkruar nga ata.

Nëse dikush nga ju prezent në sallë do të duhej të kishte motiv të fuqishëm për ta votuar këtë projektligj, ata janë të gjithë në anën e opozitës. U përmend edhe një gjë, u përmend Ligji për paga dhe fakti që Qeveria nuk e ka buxhetuar Ligjin për paga. Prapë po mendoni ta manipuloni opinionin, ta dezinformoni. Ligji për paga nuk mund të buxhetohet kur është i pezulluar, në nivelin lokal ne e kemi buxhetuar një rezervë prej 36 milionë eurove, të cilat komunat mund t' i përdorin vetëm për pagat që nga momenti kur ligji hyn në fuqi, kur Gjykata Kushtetuese e merr një vendim. Mos gënjeni opinionin. Mjetet janë aty, edhe me nen në ligj kemi paraparë që nuk mund të përdoren për diçka tjetër. Në rast se Gjykata Kushtetuese merr vendim tjetër, prapë mjetet u mbeten komunave, vetëm u rialokon për projekte kapitale. Në nivel qendror kemi kontingjentet prej 40 milionë eurove për t'u përballur me shpenzimet e paparashikuara që na dalin si rezultat i nismave ligjore, të papërgjegjshme të qeverisë së kaluar. U tha nga disa prej bashkëfolësve këtu që ka ekzistuar vullneti për bashkëpunim, ka ekzistuar gatishmëria për bashkëpunim, ja që u prish nga qeveria. Në qoftë se vullneti për bashkëpunim dhe gatishmëria për bashkëpunim ka ekzistuar, duhet të jeni të lumtur që kaloi kjo, atëherë jemi në një vijë. Projektligji kaloi, mocioni kaloi, do të votohet projektligji, jemi në të njëjtën vijë.

Mirëpo, në qoftë se ne nuk arrijmë të aprovojmë Projektligjin për buxhet në kohë urgjente, ne nuk mund të zbatojmë as vendimin e qeverisë për ndarjen e 10 milionë eurove për përballje me pasojat e infeksionit virus. Nuk ka buxhet, nuk mund të bëhen alokime, nuk mund t'i paguajmë ndihmat sociale, për të cilat 28 mijë familje kanë nevojë urgjente. Ne po planifikojmë që të gjithë përfituesve të ndihmave sociale t'u japim si paradhënie edhe ndihmat për muajin prill, në mënyrë që të ballafaqohen me shpenzimet enorme që i kanë tash. Ne po planifikojmë të fillojmë pak më herët mundësisht nëse buxheti aprovohet, edhe me transferimin e pensioneve, në mënyrë që të krijohet një plan që pamundëson grumbullimin e pensionistëve para sporteve bankare.

Këto nuk mund t'i bëjmë në qoftë se ne kemi luksin ta bllokojmë qeverinë përmes votimit të sotëm. Ne i kemi rezervat në zero, rezervat në zero nuk i ka sjellë kjo qeveri, rezervat shtetërore në zero i keni sjellë ju. Sa më herët ta miratojmë buxhetin, aq më shpejt mund të punojmë edhe në rikuperimin e rezervave shtetërore. Krejt në fund, në qoftë se ka veç diçka të panatyrshme në debatin e sotëm është kjo, ne jemi duke debatuar projektdokumentin më të rëndësishëm të vitit 2020, Projektligjin për buxhetin e shtetit. I vetmi person, i cili vite me radhë është marrë me buxhetin e shtetit në këtë sallë është zoti Hamza, që është edhe kryeshef i Grupit Parlamentar. Mirëpo, ai zgjodhi sot të diskutojë për buxhetin, por për buxhetin e shtetit edhe për sa na duhen neve për t'u përballur me coronavirusin, ia la një këngëtarit të na tregojë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, zoti ministër! Replikë zoti Bedri Hamza.

BEDRI HAMZA: Faleminderit, zonja nënkryetare!

Disa herë kam dalë në atë foltore dhe kam arsyetuar buxhetin e Kosovës, nuk them që ka qenë perfekt, nuk them që s'ka mundur të jetë më mirë, por të paktën janë këtu deputetët pozitivë e opozitivë, u jam drejtuar me shumë respekt dhe me shumë mirësjellje.

Sidoqoftë, mua më ftoi për të diskutuar për buxhetin, por realisht nuk u krijua hapësira për të diskutuar për buxhetin. Unë nuk them që ka mundësi buxheti të jetë kështu ose ashtu, por kisha dhënë mendimin tim profesional dhe anën profesionale nuk e cenoj as për politikë, as për asgjë tjetër. Ato që i them, i them me bindje, i them bazuar në analizat më të mira profesionale, nuk do të thotë që gjithmonë analizat e mia janë të sakta. Por, ministrit po i tregoj: ka pasur problem të bëhet buxheti, edhe pse ka një ekip të jashtëzakonshme, edhe më problem do ta ketë ta ekzekutojë. Edhe, në proces e sipër të jeni të sigurt që koha do t'juja sipërfaqësojë defektet dhe çështjet e caktuara, edhe veç një fjali po e them dhe po e përmbyll. Tri momente: premtimet elektorale, programi i qeverisë dhe buxheti kanë një diskrepancë të jashtëzakonshme. Nuk është programi, nuk janë premtimet të reflektuara në buxhet dhe shteti ka...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: A e përfunduat zoti Hamza ose do të keni kohë prapë. Atëherë, po vazhdoj ashtu siç janë paraqitur me radhë, nga LDK-ja është paraqitur Armend Zemaj. Nuk jua ka përmendur emrin, zoti Demaliaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Të nderuar kolegë deputetë,

Zoti kryeministër,

Tash sot është pak komplekse edhe diskutimi, sepse qytetarët e vendit janë ngarkuar apo më mirë të them të shqetësuar për shpërndarjen e virusit të coronavirus, me shumë arsye.

E di që sot më së paku edhe ata vlerësojnë procedurat kuvendore, të cilat janë legjitime, por ata presin një lloj unifikimi politik, së paku sot, për të kaluar gjendjen emergjente dhe kthimin në normalitet. Në seancën e 11 marsit e parashtrova këtë çështje me seriozitet, edhe pse kishim një temë ruajtjen e marrëdhënieve Kosovë - SHBA, theksova që në Kosovë do të duhej të ishim më vigjilent dhe të marrim masa ndaj shfaqjes së coronavirusit, duke pasur për bazë që tash ishin prekur edhe vendet fqinje. Edhe pse menjëherë çështja kaloi në seriozitet dhe vendimet e qeverisë, besoj që ka ngritur edhe vigjilencën edhe përgjegjësinë edhe të deputetëve, edhe të të gjitha institucioneve vendimmarrëse në Kosovë. Sa i përket buxhetit, pak është vështirë të analizojmë dhe të kalojmë nëpër tematikë, sepse është e njohur tash që sot deputetët e kanë marrë draftin, është për t'u kritikuar, por nuk është për t'u nënvlerësuar situata, por mendoj që pak a shumë duhet të kalojmë përmes disa elementeve, të cilat neve mendojmë edhe si deputetë,

edhe si përfaqësues se ky buxhet duhet të jetë funksional, zhvillimor dhe që përmbush interesat e qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Tani kjo humbja e interesave ekonomike të dikujt nga opozita është parë e rëndë dhe po shihet si vështirë e kalueshme, por mendoj se kjo nuk duhet të jetë shkas që të dëmtohen projektet investive dhe që janë interes nacional. Andaj, nëse e shikojmë te pjesa sidomos ajo që edhe ne marrim sugjerime, marrim edhe porosi, sepse jemi përfaqësues të qytetarëve të vendit dhe projektet infrastrukturore dhe ato të mirëqenies mendoj që duhet të shikohen, së paku të vlerësohen në këto procedura të shpejta, të cilat na kanë mbetur. Tash nëse e analizojmë faktin që këto vendime të qeverisë, siç ishte vendimi i ministrit të Infrastrukturës për ndaljen e asaj zhvatjes, atij 110-milionshit, sigurisht do të na interesonte shpërndarja apo ridestinimit i tyre për të përmbushur interesat ekonomike të qytetarëve të vendit dhe këtu do të duhej ta kishim edhe ne fokusin tonë.

Ajo që desha ta theksoj, mendoj që rruga që kalon nga Gryka e Deçanit në drejtim të Plavës është arteria kryesore dhe më e rëndësishme zhvillimore për komunën e Deçanit. Problemet që kemi me Manastirin janë probleme evidente, të njohura, bile-bile kemi pasur rastin kur edhe ndonjëherë është dashur të protestohet, pjesë e kësaj ka qenë edhe kryeministri aktual dhe besoj që kjo nuk duhet të jetë si pengesë që ai projekt të financohet dhe të shohim apo të rishohim mundësitë edhe të bashkëpunimit dhe tejkalimit të këtij problemi që ajo rrugë të vihet në funksion. Ajo çka është evidente dhe është e njohur ka pasur parregullsi prej fillimit, por mendoj që nuk duhet tash të mbetemi peng i parregullsive të dikujt tjetër, janë organet kompetente që duhet të vlerësojnë mospërmbushjen apo përmbushjen e çdo projekti, sipas ligjeve në fuqi.

E dyta, komunat në përgjithësi kanë problem me ujërat e zeza dhe me ujë të pijes. Por, disa e kanë rregulluar këtë problem, komuna e Deçanit akoma vuan, disa fshatra edhe sot e kësaj dite nuk kanë ujë të pijes dhe nuk i kanë të rregulluara ujërat e zeza, të cilat janë shqetësuese, nëse e shohim edhe këtë për të cilën sot është ngritur e gjithë Kosova, siç janë sëmundjet infektive. Po flas konkretisht për një regjion të caktuar, siç janë fshati Strelci i Epërm, Isniq, Dubovik, Lebushtë e të tjerë, ku Strelci i Ulët, ku është më se e nevojshme që ky projekt të futet në linjën buxhetore, edhe përmes ndoshta kredive, të cilat janë të favorshme në bashkëpunim me Komunën dhe të tjerët dhe qytetarët ta kenë në pronësi.

Të nderuar ministra,

T'i drejtohem vetëm kryeministrit ndoshta është e padrejtë, por ministrat e linjës duhet ta kenë fokusin e qartë dhe të përmbushjes apo të shpërndarjes së saktë buxhetore ashtu siç kërkohet jo vetëm prej neve, sepse këtu nuk bëjmë garë të fuqisë së votës, apo fuqisë elektorale, por mendoj që duhet të analizojmë me saktësi projektet, të cilat janë më së evidente. Ajo çka sot është e nevojshme dhe unë e besoj që duhet të jetë një motiv për punën e mantelbardhëve, të kemi parasysh jo vetëm si pjesë emergjence, por si pjesë e një mbështetje së paku me një shumë

monetare të shtesave të mbështeten mantelbardhët, policët dhe ata të cilët merren me emergjencë. Kjo shihet nëse dikush ka pasur rastin t'i vizitojë marketet dhe t'i shohë ekonomitë dhe shportat familjare, mund ta bëni dallimin nga fuqia ekonomike e këtyre strukturave për të përmbushur një kosto apo një rezervë familjare për një afat caktuar, nëse kërkohet mbyllja e ekonomive familjare dhe familjeve për dy-tri javë apo një muaj. Besoj se kjo duhet të jetë primare dhe të shohim bashkërisht që ta kemi një mbështetje të tillë.

E dyta që desha ta theksoj dhe besoj që e fundit, por jo për nga rëndësia, ka të bëjë me buxhetin në të cilin mbështeten edhe organizatat buxhetore që nuk kanë arritur që të kenë barazi buxhetore në shumë drejtime. Dhe tash për t'i theksuar si fakt çdoherë na shkon mendja në profile të cilat kanë nevojë për sundim të rendit dhe ligjit, e ajo është gjyqësia në Kosovë dhe sistemi i drejtësisë, në përgjithësi. Gjyqtarët, prokurorët, jo në atë shumën të cilat janë të ekspozuar, por po flas më shumë për stafin mbështetës dhe për ata të cilët janë gardianë të parë të ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike në Republikën e Kosovës.

Dhe, për fund, asnjëherë nuk do të dëshiroja të kemi situata kur ne bëjmë garë me shembuj të këqij të së kaluarës, as votimi paraprak për ta kaluar Buxhetin dhe të mos bëhemi imitues të PAN-it në situata të caktuara, por të jemi vetvetja dhe t'i kalojmë përgjegjësitë tona, edhe ligjore, edhe kushtetuese, ashtu siç presin qytetarët e Republikës së Kosovës me shpresë dhe besim për ndryshim substancial përmbajtjesor dhe efektiv në përmbushjen e obligimeve të qeverisjes së mirëfilltë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, zoti Zemaj! Replikë. Regjia, ju lutem fjalën deputetit Shkumbin Demaliaj.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, kryetare!

Jam mirënjohës shumë deputetit Zemaj, që e pat fjalën para meje. E bëri mirë që foli ai, edhe pse e pata të drejtën e replikës, sepse e demantoi gjithë atë analogji që po e bën ministri në raport me projektet e Deçanit. Po thotë, nuk është Deçani më i madh se Fushë Kosova, ose Fushë Kosova, anasjelltas. Ndhimjoju të dyjave, ministër!

E ke obligim për t'i këqyrë krejt njëjtë, po dije se jemi kah flasim për një zonë të shkatërruar, edhe pa bazë infrastrukturore, por ai projekti më i madhi që ju e keni sakatuar, e keni ndërprerë, nuk është projekt vetëm i Deçanit, por është projekt nacional. Është e vërtetë që është i kushtueshëm, po më erdhi mirë që deputeti paraprakisht e tha atë se çka duhet atje. Krejt janë pa ujësjellës, pa rrugë, s'ka pasur bazë infrastrukturore, por meqenëse e keni vendosur kështu... se edhe dje në Komision e ke bërë të njëjtën analogji. Po e krahason Deçanin me disa komuna që infrastrukturën e kanë të rregulluar në kohën e Titos e të Miloshit e... të tjerat. Ai është i shkatërruar edhe një herë, në zero është shkatërruar gjatë luftës. Po, janë të nevojshme ato. Nuk janë kërkesa të grupeve të deputetëve, se ndoshta për shkak se Aleanca e ka bazën atje, e keni

marrë kaq shumë “me hu në krah”. Ju kisha lutur që bile këto krahasime të mos i bëni, e keni në dorë, i keni votat, edhe për veprimet e mëhershme i keni pasur votat, por e keni gjetur këtë formë edhe këtë pozicionim, ishalla ju ndihmon edhe Zoti!

KRYESUESJA: Faleminderit, zoti Demaliaj! Fjalën e ka deputeti Memli Krasniqi nga PDK-ja.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, kryesuese!

Është për keqardhje që kryetarja e Kuvendit iku prej seancës, sepse ajo është tash zonja e shtëpisë këtu dhe nëse kreujt deputetët kanë ardhur sot me një paralajmërim disaorësh në ditë të shtunë, ajo do të duhej të rrinte këtu, se përgjegjësinë për degjenerimin total të kësaj seance e ka më së pari Vjosa Osmani.

Përkundër që s’është këtu, unë e kam obligim edhe asaj me iu drejtua pak dhe t’i tregoj asaj dhe opinionit publik që është hera e parë sot që kreujt e keni nisur mbrapsht këtë seancë, duke filluar prej faktit që e keni thirrur seancën në kundërshtim me praktikën e përhershme të Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, ku sa herë që ka seancë të jashtëzakonshme, pavarësisht prej kujt thirret, mbliidhet Kryesia dhe e konfirmon mbajtjen e seancës. Na e keni kërkuar dje miratimin, ua kemi dhënë. Jemi pajtuar ta mbajmë Kryesinë dhe pastaj s’e keni mbajtur fjalën. Kjo ka qenë shenja e parë që ju ndërmend ta mbani fjalën për kurrgjë nuk e keni, por ne s’kemi besuar që bash deri në këtë nivel do të silleni.

Keq që s’është kryetarja, sepse u mundua ta bëjë një dallim prej kryetarit të kaluar, zotit Veseli, por atij kurrë nuk i ka ndodhur një gjë e tillë. Nja 34 seanca opozita i ka kërkuar veç në fillim të vitit të kaluar për nja 3-4 muaj dhe të gjitha janë mbajtur. Dhe, kur ne atëherë si deputetë të koalicionit në Qeveri nuk u kemi ardhur në seancë, ish-kryetari ka ardhur dhe ua ka udhëhequr seancën kur keni mundur të filloni, se zakonisht s’kemi mundur, se s’kemi pasur kuorum. Ju e dini këtë mirë dhe keq që një kryetare që ka dashur me dhënë njëfarë shembulli të mirë e ka nisur shumë mbrapsht.

Unë s’do të ju flas për Buxhetin, sepse Buxheti është siç është, por nëse ka diçka që populli shqiptar e konsideron vlerë të përhershme prej ekzistencës së vet, ajo është besa. Është fjala e mbajtur. E ju sot si koalicion pa fije turpi, edhe atë “live”, drejtpërdrejt në transmetim, ju na pretë sot në besë. Pra, ju publikisht sot e konfirmuat që jeni besëprerë, ju qoftë për nder, por ky nder nuk është. Edhe nuk mund të besoj që ka turp më të madh për një politikan se të jetë besëprerë dhe atë ta konfirmojë para dy milionë qytetarëve, që sot po ma merr mendja, pasi janë nëpër shtëpia, kreujt na kanë parë “live”. Bile, po më vjen keq që me diktat tuajin i keni shtyrë edhe disa deputetë të jenë pjesë e kësaj besëprerjeje pa vullnetin e tyre, sepse unë kurrë nuk besoj që ata kanë kaq mungesë të madhe të moralit, sepse shumë prej tyre i njoh me vite, pavarësisht kemi qenë a s’kemi qenë në pozicione të njëjta politike. Ama, ju që e keni orkestruar këtë trafikim të mocionit me vetëdije, bash turp ju qoftë!

Arben Gashi tha më herët që po i vjen keq prej Bedri Hamzës. Prej Bedri Hamzës duhet t'i vijë shumë keq, po duhet t'i vijë keq prej krejt deputetëve të opozitës, të cilët sot kanë ardhur për të diskutuar për Buxhetin dhe ta gjejnë një rrugëdalje të përbashkët. Kryetarja u mundua të shfaqësohet në mënyrë naive, se ka pasur përshtypje që deputetët e opozitës nuk po duan të vijnë. Por, ky ishte një mashtrim i dobët. Ne sikur të mos kishim dashur të vijmë, s'do të kishim ardhur sot në seancë hiç. Po, ne erdhëm këtu në seancë dhe ju thamë që duhet ta gjejmë një zgjidhje, jo të trafikimit, siç e patët qëllim dhe po e arrini, por një zgjidhje të përbashkët, se jemi duke folur për Buxhetin, i cili nuk është veç i Qeverisë, por është i qytetarëve dhe për të ka obligim secili deputet.

Ju e dini që kontakti është gjithmonë i mundshëm. Ne këtu secili e dimë e i kemi edhe numrat e njëri-tjetrit, s'do të flas me emra, por mua më kanë kontaktuar edhe të koalicionit qeverisës sot e dje për këtë seancë. Nganjëherë, kur janë nxënë i thonë sekretarit të Kuvendit të na kontaktojnë. Sigurisht rasti dje për mbledhjen e Kryesisë që u pajtuam ta mbajmë dhe pastaj nuk u mbajt. Po ju kërkuat këtu konsensus, kryetarja e Kuvendit kërkoi konsensus. Nuk u hodh mocioni në votim, se ju e dini që s'do të kalonte. U kërkua konsensus, e në zyrën e saj shkuam për ta arritur konsensusin, i cili nuk ishte krejtësisht i thjeshtë, e as i lehtë, por që pati një zgjidhje, e pati një zgjidhje. Por, ju e vazhduat pas shpine seancën.

Mos u arsyetoni duke thënë "I kemi thirr, i kemi rënë ziles në 17:20, në 17:30..." Kujt bre po ia kallëzoni këto kopalla? Këto janë hajgare, bre! Po sa e sa herë janë mbajtur seanca këtu, e janë dhënë pauza 10 minuta, e që janë bërë 30 e 30, e që janë bërë një orë e ndonjëherë 30 kanë qenë 15... po ne krejt ishim në komunikim, edhe ne si opozitë, edhe ju si koalicion, edhe bashkë koalicion e opozitë.

E ajo, tregonte kryetarja, qysh ka besuar, ose e ka lexuar situatën kështu, ose ashtu. Po nuk udhëhiqet bre institucioni më i madh në vend me perceptcion, plus nuk jemi duke u parë në televizion, ne jemi këtu njëri me tjetrin, ishim duke diskutuar. Përveç shfave të grupeve pati edhe diskutime tjera ndërmjet deputetëve. Dhe po më vjen keq, se me të vërtetë e kam pasur një konsideratë, por me këtë mashtrim që ajo e ka udhëheq vetë, sepse ajo ka qenë atje lart që e ka kërkuar votimin. Unë jam skajshmërisht i befasuar për të keq, pa dyshim, se ajo, mbi të gjitha, si politikane e gjeneratës së re, s'e di çfarë shembulli po jep kështu.

Këqyre, ju Buxhetin e kishit kaluar. A ju bën nder bre kjo mënyrë, o kryeministër, a të bën nder ta kalosh kështu Buxhetin? Për besë, jo! Ti mund ta kalosh Buxhetin mbas tri-katër ditësh, pesë ditësh, e ka pasur mundësinë ta kalosh qysh erdhëm në dakordim. Po çka keni arritur ju sot krejt është ta mbytni Buxhetin dhe ta kaloni, në fakt ta mbytni debatin për buxhetin, edhe ta kaloni pesë ditë më herët. Kaq! Ama, e keni bërë dëmin më të madh që keni mundur ta bëni në raportet pozitë-opozitë, jo se kanë qenë këto raporte shumë të mira e miqësore, por këto raporte janë të nevojshme për këtë Kuvend, bre! Sepse, në këtë Kuvend nuk votohet veç Buxheti. Ju sot i keni

shkatërruar këto raporte dhe nuk do të mund ta rikuperoni këtë raport. E në nja tri seanca të fundit kemi folur për idenë dhe nevojën e konsensusit dhe të dakordancës. Shikoni, duhet ta kujtoni këtë ditë kur të ju vyejnë prapë numrat e opozitës, se rrallë, rrallë, po ju vyejnë ata numra. Ju kanë vyejtur në dy-tri seancat e kaluara. Kanë për të kaluar dhjetë që s'kanë për t'iu dashur, po ka për të ardhur një që do t'iu duhen. E atëherë?! Nuk keni lënë vend për të diskutuar. E në seancën e parë, unë vetë jua kam përmendur arrogancën dhe numrat dhe ju kam thënë, po ju flas prej përvojës.

Nuk ka send më të keq për një koalicion se ta ketë arrogancën e numrave, e ju nuk është që keni shumë numra, por është shumë keq të mashtroheni që e kryeni menjëherë. Sot e keni arritur qëllimin, debat s'ka, ligjin e kaloni, atë ministrin e vogël e keni shpëtuar prej ballafaqimit me deputetët. Tash ai e rren veten që e ka bërë Buxhetin e mirë, se deputetëve nuk u keni dhënë mundësi të ju tregojnë me argumente dhe mungesën e dijës dhe të aftësisë për të qenë ministër i Financave, por çka tani, çka më vonë? A mendoni që përfundon krejt këtu? Jo, nuk përfundon krejt këtu!

Dhe, po më vjen keq, se i pashë disa prej ministrave e ministreve, edhe disa prej deputetëve, duke u zgërdhirë me gëzim që na keni mashtruar. Por mos, se s'është nder që na keni mashtruar. E nëse doni të keni nder, ju qoftë për nder juve edhe familjeve tuaja, ju qoftë për nder, e mbajtshi përjetë, se nëse nuk skuqeni me këtë që e keni bërë sot, besoj se kurrë nuk keni për t'iu skuqur.

A e dëshmuat saktë edhe një gjë që ua thashë në fillim, që kjo seancë lidhje, ama bash lidhjen më të vogël me pandemi të coronavirusit për çka s'jeni duke u marrë seriozisht, nuk pati. Ju e arritët veç atë qëllim që e keni pasur - t'i heshtni deputetët, ta trafikoni Buxhetin në mënyrë pothuajse klandestine, duke i respektuar procedurat. E qysh? Duke i prerë në besë njerëzit me të cilët ishit duke diskutuar për të gjetur zgjidhje të përbashkët.

E për që e keni masakruar Buxhetin, këtë e kuptojnë qytetarët me kohë, e ju kënaquni sot, pasi u gëzuat, kënaquni në mashtrimin dhe besëprerjen që ia bëtë opozitës, por ta dini se i bindur jam herë do kurdo disa keni për t'iu bërë pishman, sepse krejt çka keni arritur është ta shkatërroni edhe mundësinë e fundit të raporteve pozitive-opozitive për tema shumë më të rëndësishme sesa Buxheti, se për Buxhetin s'keni nevojë ta keni 2/3-at e votave, keni mundur ta kaloni pas pesë ditëve, ashtu siç ju propozuam ne, në lexim të dytë. Dëshët të nguteni, nuk deshët të keni debat, është për çudi, hera e dytë që ndodh në historinë e Kosovës. Hera e parë, ministër, e ke pasur atë që e ke në të djathtë ministër, Avdullahun, dhe hera e dytë është sot kur je vetë kryeministër.

Për besë, krejt i kisha besuar, veç që e ulni deri në këtë nivel jetën parlamentare kurrë nuk kisha besuar. Kurrë! Për çka? Për ta kaluar Buxhetin nja tri-katër ditë më herët. Marre!

KRYESUESJA: Kryeministri e ka fjalën.

KRYEMINISTRI ALBIN KURTI: Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Si Qeveri, sonte do të na duhet ta marrim vendimin në mënyrë elektronike për votim, që edhe Malisheva të vendoset në situatën e njëjtë, sikur Klina e Vitia. Pra, bëhet fjalë për një situatë të pazakonshme. Është një situatë e paparë në Kosovën e pasluftës, situatë e pazakonshme dhe unë e falënderoj opozitën që sot kanë ardhur në këtë seancë të jashtëzakonshme.

Unë besoj që opozita ka bërë mirë që ka ardhur në këtë seancë të sotme, duke pasur parasysh qëndrimin e opozitës për Buxhetin në një situatë të pazakonshme, mendoj që kanë bërë mirë që janë vonuar pas pushimit. Ndërkaq, për deputetët e shumicës mendoj se kanë bërë mirë që kanë votuar. Mendoj që edhe opozita ka bërë mirë që është ankuar pas kësaj, por vetëm tash mos të zgjatet shumë kjo. Pra, situata është e pazakonshme, ku edhe ardhja juaj është e mirë, edhe vonesa juaj është e mirë, edhe votimi ynë është i mirë, edhe ankesa juaj është e mirë, veç do të kishte qenë mirë të mos zgjatet tash, se situata është e pazakonshme.

KRYESUESJA: Faleminderit për fjalën! Zoti Krasniqi, për hir të korrektësisë, kryetarja do të kthehet shumë shpejt. Ka pasur një obligim të shkurtër dhe sa i përket çështjes që e adresuat për mbledhjen e Kryesisë, nga Sekretaria jemi kontaktuar të gjithë nënkryetarët dhe shefat e grupeve parlamentare dhe na është kërkuar që të japim pëlqimin për vazhdimin e procedimit të seancës. 4 nga ne nënkryetarët kemi qenë pro thirrjes së kësaj seance, nga Lista serbe kanë qenë kundër, meqenëse ju nuk jeni lajmëruar në telefon është kontaktuar shefi i Grupit Parlamentar, zoti Hamza, i cili ka thënë se janë të vetëdijshëm që nuk mund ta pengojnë tutje. Pra, këta nuk kanë qenë për të vazhduar në këtë mënyrë, por ka qenë vetëm një votë e tyre.

Dhe, në lidhje me këtë që e tha edhe kryeministri, situata është vërtet e jashtëzakonshme. Unë besoj se është e rëndësishme që secili, edhe kryeministri dhe të tjerët, të marrin përgjegjësitë që janë të jashtëzakonshme për këtë situatë të pandemisë botërore në të cilën jemi. Diskutimet nuk është se po i ndihmojnë shumë çështjes dhe ju kisha lutur shumë të gjithëve, që të jemi vërtet shumë racionalë dhe në nivel të detyrës. Do të kemi kohë për t'i diskutuar çështjet politike. Ajo që është më e rëndësishmja sot është që të procedojmë tutje, sepse të gjitha shqetësimet që ju i përmendët sa i përket pajisjes së punëtorëve shëndetësorë dhe të gjitha çështjet tjera, nuk mund të vazhdojnë të realizohen, pa u votuar Buxheti. Neve na pret, së paku edhe 4-5 orë punë deri në votimin e dytë. Ju kisha lutur shumë, që të jeni të gjithë racionalë dhe të diskutojmë për çështjet që duhet domosdoshmërisht të diskutojmë. Politikë do të kemi kohë të bëjmë prapë.

Fjalën e ka kërkuar deputeti Arben Gashi dhe pastaj e bën replikën.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Memli, sa i përket çështjes me zotin Hamza, unë e sqarove dhe e stërsqarova, s'po dua të thellohem në atë punë.

Një çështje është e sigurt, deputetët e kanë pasur për detyrim ligjor në orën 17:20 të jenë në sallë dhe nuk ndiej asnjë lloj përgjegjësie ndaj deputetëve, hiç, ndaj asnjërit prej deputetëve. E shpreha keqardhjen dhe e stërsqarova lidhur me raportin me zotin Hamza, ndërsa për të tjerat të gjithë deputetët janë të barabartë. Thirrja ka qenë me mikrofon e hapur prej kryetares së Kuvendit, që deputetët duhet të jenë në sallë në orën 17:20. Zilja prej orës 17:45 ka rënë... s'ka rëndësi më kjo, se u përsërit 100 herë. Çka dua të them, është e vërtetë edhe ajo që thatë ju, se me dhjetëra herë seancat janë... njerëzit janë vonuar për t'u kthyer në seanca, janë kthyer pas një ose dy orësh, ose pas shtatë orësh, kur e kemi votuar Qeverinë e kaluar, por sot e kemi pasur një orë të caktuar kur të kthehemi. Ne jemi kthyer dhe ka ndodhur ajo që ka ndodhur, jemi në seancë dhe besoj se gjithçka do të jetë në rregull. Faleminderit!

KRYESUESJA: Regjia, kundër-replikë zotit Krasniqi fjalën, ju lutem!

MEMLI KRASNIQI: Dy minuta, tregoju!

Kryesuese, na mbajte një ligjëratë, por e vërteta është kjo dhe nëse e kishe dëgjuar fjalën time saktë, unë thashë në kundërshtim me praktikën e përhershme. Deri para disa muajsh edhe ne në Kuvend, tash që jemi në opozitë, e kemi pasur shumicën, por nuk i kemi kryer këto punë me telefona. Mbledhja e Kryesisë duhet të thirret. Edhe nëse nuk ka qenë obligim, unë po them që ka qenë praktikë e përhershme. Dhe sot, për herë të parë, pas nja 20 vjetësh, e keni shkelur këtë praktikë, dhe kjo është keq.

Kryeministër, opozita ka të drejtë edhe të ankohet, por ti mbete duke u ankuar tash e një muaj e gjysmë që e ke marrë përgjegjësinë. Je duke u ankuar që të kanë faj të tjerët, që ka mbetur kjo punë keq, që të ka mbetur ajo punë keq... Ke mundur edhe të ankohesh sot që ne ta kemi vonuar Buxhetin, por Buxhetin e keni vonuar vetë. Kështu që, edhe nëse ankohe mi ne, me rëndësi është ti të mos ankohesh, por të punosh, se deri tash s'jemi duke parë diçka të tillë.

Arben, secili e kemi për vete, a na vjen keq, a s'na vjen keq. Por, edhe ti, edhe unë, edhe secili këtu në këtë sallë, se njerëzit jemi duke i mashtruar ngapak, se militantët edhe mund të të besojnë ty, pavarësisht çka u thua, se janë të partisë tënde, të partisë sime, edhe mund të më besojnë mua pa rezerva e së cilës parti, por e vërteta, e di bre ti që s'është kështu, se ne nuk kemi qenë jashtë, ne ishim secili nëpër sallat tona të grupeve. Për çka? Për ta vazhduar seancën. Dhe ju, ti, Rexha, Bedriu, grupet tjera... Haxhiu, ju... keni diskutuar te kryetarja, e keni lënë të mblidhemi, kanë pasur edhe diskutime me njëri-tjetrin, të mos i përsëritim se u treguan, edhe ka pasur vonesa mandej të takohemi edhe opozita të tre bashkë, e tjerë. Po ne një marrëveshje e arritëm dhe që ishte në dakordancë me juve. Ju këtë marrëveshje nuk e deshët, përkundër që e pohuat dhe na mashtruat.

KRYESUESJA: Faleminderit, zoti Krasniqi! Ndonëse nënkryetarët po thonë se ka qenë edhe praktikë e herëve të kaluara, praktika nuk vlen në këtë rast, sepse, ju lutem kuptojeni, jemi në rrethana të jashtëzakonshme. Është shpallur pandemi botërore!

Fjala për deputetin pa grup parlamentar, zotin Veton Berisha.

VETON BERISHA: E nderuar zonja nënkryetare,

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Deputetë,

Të gjithë ju të pranishëm,

Do të mundohem të jem konkret dhe ta kursej kohën për shkak të ndjeshmërisë së situatës dhe besoj që fjalimi im do të japë kontribut dhe të ndihmojë sigurisht vendimeve të kryeministrit për çështjet për të cilat ne po flasim.

Pjesa e parë e fjalimit ka të bëjë me masat e ndërmarra nga kryeministri dhe Kabineti qeveritar për veprimet për parandalimin e shpërndarjes së virusit corona, të cilat unë i kam përshëndetur edhe në mbrëmjen kur janë marrë vendimet. Megjithatë, konsideroj që ekziston një mungesë e kontributit të personave të pranishëm në atë komision, e sigurisht edhe atyre që e kanë këtë mundësi për të kontribuar më drejtpërdrejt te Zyra e Kryeministrit dhe besoj që ky komision do të duhej ta vlerësonte edhe anën tjetër. Pas marrjes së masave, masat kanë ndikuar jashtëzakonisht keq në komunitetet rom, ashkanlinj e egjiptian sidomos, sepse është bërë izolim total i këtyre komuniteteve dhe pamundësitë për të lëvizur kanë shkaktuar probleme të jashtëzakonshme.

Sidomos po flas, zoti kryeministër, për kategoritë sociale të cilat vërtet janë në mes të muajit dhe do ta kenë shumë problem ta kalojnë deri në fund të muajit. Nuk e di sa ka qenë e mundur, por përfaqësuesja jonë e komuniteteve, ministrja zonja Emilija Rexhepi, me sa e di unë është në atë komision dhe sigurisht se do të duhej të na konsultonte paraprakisht se cilat janë problemet tona, sepse ajo pozitë është kategori kushtetuese dhe do të duhej të na konsultonte se cilat janë problemet dhe nevojat që kryeministri t'i dinte. Pajtohem që mund të mos i dish, por përpos zonjës Emilija Rexhepi është edhe një mundësi të informoheni nga deputeti i komunitetit egjiptian, zoti Elbert Krasniqi, i cili është veç në grupin tuaj, dhe ta kuptonit ju se komuniteti egjiptian është izoluar.

Komuniteti egjiptian ka krizë ekonomike. E ka shumë problem ta mbijetojë pjesën e parë të muajit, domethënë të kalojë deri në fund të muajit për shkak të situatës së krijuar. Pjesa më e madhe e komunitetit është e bazuar në skemën sociale, e cila është e pamjaftueshme për të kaluar deri në fund dhe ballafaqohen me një shtrenjtim të jashtëzakonshëm, i cili është vështirë të

përballohet në shoqëri për shkak se ju e dini sa ka ndodhur rritja e çmimeve, sa ka ndodhur dhe është e papërballueshme për neve.

Mendoj se në këtë aspekt duhet të kemi parasysh dhe është shumë e ndjeshme pjesa e asistencës, sidomos në mjetet higjienike dhe në pjesën e ndihmave, domethënë ndihmave për të mos u shpërndarë kjo pandemi. Andaj, i bëj thirrje edhe komisionit qeveritar që ta shikojë edhe këtë pjesë, ta analizojë e të marrë masa në ndryshimin e gjendjes dhe sigurisht që ne bashkërisht ta kalojmë më mirë.

Pjesa e dytë e fjalimit tim sigurisht se ka të bëjë me Buxhetin, i cili mua personalisht më ka ardhur sot posa jam ulur në ulësen time dhe sot e kam parë dhe normalisht që s'kam arritur ta analizoj mirë. Nuk e di cila është arsyeja, por besoj se secili deputet duhet ta ketë të drejtën e plotë që të ketë qasje në projekt-buxhet, duke e ditur që është Buxheti më i rëndësishëm, pavarësisht bindjeve tona politike, pozitive apo opozitive. Do të duhej ta japim kontributin tonë dhe ta dinim se për çka po flasim.

Unë e kam para vetes një projekt-buxhet, i cilin në kodin... kodi funksional, zoti ministër, nëse ka mundësi të më dëgjoni dhe të më jepni një përgjigje, se a është ligjore që kodi funksional 0133 parasheh projektet për komunitetet e Grupit 6+. Po dua ta di, a është ligjore që të parashihet buxhet për grupe të cilat janë grupe politike dhe nëse veprohet e njëjta praktikë, a do të duhej që edhe grupeve tjera politike t'u jepet kjo mundësi? Sigurisht se edhe grupet tjera politike do ta kërkonin këtë mundësi.

E dyta, e kemi një Buxhet i cili ka ardhur pa strategji legjislativë dhe pa Programin qeveritar. Edhe në kohën e diskutimeve me kryeministrin kam kërkuar që të kemi... a ka planprogram qeveritar, sidomos që parasheh zhvillimin e komuniteteve. Në atë kohë ka qenë në përgatitje një plan i tillë, por duke parë buxhetin e varfër të këtij viti, unë po e vërtetoj që as atëherë nuk ka pasur Program qeveritar dhe as tash nuk ka Program qeveritar, sidomos për komunitetet. Dhe, kjo ma ka forcuar bindjen e asaj që vërtet kjo Qeveri është duke i trajtuar komunitetet jo në fushën e duhur dhe jo në momentet e duhura, për shkak se në ditët e sotme asnjë komunitet nuk mund të jetë i barabartë për shkak se secili komunitet i ka specifikat e veta, në këtë rast edhe komuniteti egjiptian.

Duke ia lëshuar një sy shpejt e shpejt Buxhetit, unë e pashë që ky projekt-buxhet nuk ka politikë buxhetore ku komuniteti egjiptian i jep shpresë që atyre do t'u ndryshojë gjendja ekonomike, që ata të jetojnë nga një gjendje që është gjendje e varfërisë ekstreme në një gjendje më të mirë. Nuk pashë që ka mbështetje të infrastrukturës për vendbanimet ku komuniteti egjiptian dhe ai ashkali, flas me përgjegjësi të plotë për këto dy komunitete, asnjë projekt nuk parasheh që është i mbështetur, sidomos për jetë më cilësore dhe infrastrukturë. Nuk pash projekt-buxhet, ose linjë

buxhetore që parasheh rritjen e nivelit të punësimit për ta respektuar dhe implementuar Ligjin për shërbimin civil.

Nuk ka vullnet dhe nuk pashë plan qeveritar për kthimin e familjeve të rajonit, të cilat janë të zhvendosura nga lufta në rajon, e ato duhet të kthehen patjetër këtë vit në Kosovë. Nuk pashë në linjë buxhetore e cila do ta ndihmonte ngritjen e nivelit të arsimimit dhe zhdukjen e analfabetizmit në tërësi. Nuk pashë plan buxhetor, i cili parasheh amendamentimin e Ligjit për skemën sociale, ku do të duhej të parashihej buxhet për ndryshimin e nenit, i cili parasheh... është një nen atje, besoj se edhe zoti ministër e di, për Ligjin për skemën sociale, neni diskriminues, që parasheh kriterin pesë vjet, e ky kriter është jashtëzakonisht i dëmshëm dhe le të pambështetura kategoritë sociale.

Përfshirja në polici... nuk pashë buxhet domethënë që mund ta parashohë rritjen nga komunitetet në Polici, në Ushtri dhe në institucionet e sigurisë. Fatkeqësisht, duhet t'i kërkoj ndjesë komunitetit tim egjiptian për shkak se në këtë vit buxhetor nuk do të ketë shtëpi të reja për këto familje, të cilat kanë qenë gjatë viteve të kaluara. Nga 37 shtëpi që i ka përfituar komuniteti egjiptian nga buxheti i vitit të kaluar, sot nuk pashë asnjë linjë buxhetore që parasheh ndërtimin e këtyre shtëpive.

Një çështje shumë e rëndësishme, që kërkon linjë buxhetore është Lagjja Kolonia, apo Ali Ibra, në Gjakovë, lagje ajo që jeton në deponi të mbeturinave dhe kërkohet një fond buxhetor prej 700 mijë eurove që ajo hapësirë të pastrohet dhe njerëzit atje të jetojnë dinjitetshëm. Kamë pritur që sigurisht zoti kryeministër komunitetet tona do t'i trajtojë vërtet me prioritet, për shkak të vetë pozitës sonë. E lidh direkt me deklaratimet politike në aktivitetet ku janë ftuar nga organizata dhe përfaqësues të komuniteteve, zoti kryeministër është zotuar që vërtet do të ndikojë në planin buxhetor dhe politik që këtë komunitet ta trajtojë me prioritet dhe ta nxjerrë në një pozitë më të mirë ekonomike.

Pavarësisht dallimeve dhe bindjeve tona politike, unë mendoj se komuniteti egjiptian nuk është paraparë dhe më tregoni ku përmendet komuniteti egjiptian. Egjiptianët nuk janë në Grupin Parlamentar 6+. Edhe një herë desha t'ia tërheq vëmendjen ministrit, sepse nuk ishte i vëmendshëm, ju lutem, a ka mundësi të më tregoni qysh ka mundësi të parashohë projekt-buxhet për grup parlamentar. Për grup politik parlamentar dhe i përjashton komunitetet, në këtë rast komuniteti egjiptian është përjashtuar, sepse as zoti Elbert Krasniqi nuk është në këtë grup, dhe as Veton Berisha nuk është në këtë grup. Dhe, ky komunitet është kategori kushtetuese dhe do të duhej të parashiheshin nevojat e komunitetit. Edhe pse jam jashtë, kam pritur që zoti Elbert Krasniqi vërtet ta japë këtë kontribut, sepse është vetë në grupin ku do të duhej t'i inicionte këto procese. Megjithatë, akoma ka kohë për të mbetur dhe këto ndryshime duhet bërë. Ndryshimet nuk mund të bëhen, nëse nuk ka parashikim buxhetor dhe nuk ka planifikim buxhetor, as në projekt-buxhet, as në planin legjislativ dhe as në buxhetin, i cili është paraparë.

Për krejt grupin janë paraparë vetëm 500 000 euro. Më kujtohet, vitin e kaluar ka qenë po ashtu linja buxhetore për komunitetet tjera. Zoti ministër, më tregoni pse është hequr, është larguar kjo linjë. S'po dua të besoj se është fakti që unë nuk e kam votuar Qeverinë dhe tash është një lloj hakmarrjeje ndaj komunitetit egjiptian. Ajo linjë buxhetore, nëse ka mbetur kjo linja prej 500 000 eurosh për Grupin Parlamentar 6+, unë besoj që duhet të kthehet, e cila u përket edhe komuniteteve tjera.

E ftoj kryeministrin dhe komisionin, i cili është krijuar, që qysh nesër të dalin dhe t'i shikojnë komunitetet, sidomos komunitetin egjiptian se si është duke jetuar këto ditë dhe jam i gatshëm të kontribuoj në marrjen e masave. Domethënë, kërkoj bashkërisht të dalim e t'i identifikojmë këto familje të cilat duhet të ndihmohen edhe me izolimin në të cilin jam. Unë jam i gatshëm, pavarësisht pozicionit tonë, që të kontribuoj që secili qytetar të jetojë më mirë e në këtë rast, normalisht se jam i thirrur që të kontribuoj për komunitetin që më ka sjellë këtu me rreth 5 000 vota dhe normalisht kjo votë e atyre njerëzve duhet të respektohet dhe thjesht edhe deputetin e 900 votave duhet ta thërrasë ndërgjegjja dhe të kontribuojë më tepër që ky komunitet të jetë më mirë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, zoti Berisha! Për replikë është lajmëruar deputeti Elbert Krasniqi.

ELBERT KRASNIQI: Faleminderit, kryesuese!

Unë nuk e di çka kishte bërë Vetoni po të mos isha unë në Kuvend dhe të merret veç me mua dhe me emrin tim.

Sidoqoftë, Veton, nëse do ta ndihmosh komunitetin veç votoje Buxhetin. Lëre popullizmin në këto momente delikate. Coronavirusi nuk njeh etni. Thjesht, nuk njeh etni. Jemi të rrezikuar të gjithë, edhe ne nga grupet tjera që jetojmë në Kosovë.

Sa për projekte direkte për përmirësimin e jetës së komuniteteve të ftoj të kesh edhe pak durim, e votojmë Buxhetin. Mandej, mund të hysh në Facebook te unë dhe t'i lexosh të gjitha. Kështu që, lëre popullizmin, Veton, jemi në situatë delikate. Votoje Buxhetin, edhe hesht!

KRYESUESJA: Faleminderit, zoti Krasniqi! Kundër-replikë një minutë, deputetit Berisha.

VETON BERISHA: E mirë kjo kultura e replikës dhe kundër-replikës, sepse po reflektojmë, po ju shohim juve dhe tash edhe kjo edhe tek ne dhe është shumë pozitive.

Zoti Krasniqi, asnjëherë nuk do të hesht derisa thirrrem dhe kemi të drejtë dhe kemi interes për ta mbrojtur atë komunitet, i cili na ka sjellë këtu. Nuk do të hesht asnjëherë para asnjë lloj pozicionimi dhe asnjë lloj... s'e di as arsye pse qëndron aty. Edhe Buxhetin e keni përpara dhe do ta shohim, sigurisht se do ta shohim pas sa kohe se çfarë do të ndodhë. Do të merrem me ty

për shkak se je deputet që e ke marrë atë komunitet dhe e ke marrë përgjegjësinë për ta përfaqësuar.

E di që secilin e kap coronavirusi, por besoj edhe ti e di që komuniteti egjiptian, ashkali dhe rom, dhe krejt këtu në sallë e dinë që ai komunitet jeton në varfëri ekstreme, e ka gjendjen më të rëndë ekonomike dhe sigurisht masat e ndërmarra atë komunitet timin dhe tëndin e kanë izoluar, sepse ai komunitet nuk ka të ardhura e rroga që ai mund t'i përballojë, që të blejë 100 kg miell me çmimin ekstrem. Kështu që, reflekto, se ia vlen!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjala për përfaqësuesin e Grupit 6+, zotin Fikrim Damka.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, kryetare!

Të nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Veç një fjalë, shumë shkurt. Veton, bëje ndonjë amendament. Në Komision të Buxhetit e ke përkrahjen time, jo veç për komunitetin tim, edhe për komunitetin tuaj.

Nuk do të analizoj dhe të elaboroj me shifrat e Buxhetit 2020, por sa kam pasur mundësi të vërej paska filluar buxheti i asfaltit të kalojë në buxhetin për projektet vitale, edhe për komunitetet, edhe për shoqërinë e Kosovës. Kemi nevojë t'i orientojmë të ardhurat prej Doganës në ndërmarrjet publike, edhe për ndërmarrje private. Besoj se është koha t'i stimulojmë dhe t'i subvencionojmë ndërmarrjet, sepse e vetmja rrugë e daljes prej krizës ekonomike është përfaqësimi dhe përforcimi i ndërmarrjeve.

Kemi nevojë për projektet vitale. Kemi nevojë për projektet të cilat sot është një fenomen coronavirusi dhe po shohim që ende nuk jemi gati të përballojmë dhe të luftojmë kundër këtij virusi. Unë do të përmend vetëm një projekt, i cili sot po e shoh që është shumë i rëndësishëm. Është projekti për Komunën e Mamushës. Është projekti kur është paraparë 2019/2020 të ndërtohet QKMF në Mamushë. Por, sipas projektit të Ministrisë së Shëndetësisë, ky projekt e ka kaluar projektin që është paraparë prej projekt-buxhetit. Këtë vit, në projekt-buxhet po shohim që janë ndarë 200 000 euro për këtë vit dhe 200 000 për vitin e ardhshëm, por projekti i cili është hartuar prej Ministrisë së Shëndetësisë është komplet 800 000 euro. Unë pres edhe prej Ministrisë së Financave, edhe prej Ministrisë së Shëndetësisë, të gjejnë një modul që këtë vit të ndajmë 400 000 euro dhe vitin e ardhshëm të ndajmë edhe një 400 000 euro, me çka do ta kishim shpëtuar jo vetëm Mamushën, por edhe fshatrat që janë përreth Mamushës.

Ministër, unë pres përkrahjen tuaj dhe përkrahjen e Ministrisë së Shëndetësisë të fillojmë këtë vit ndërtimin e kësaj QKMF-je në Mamushë. Nuk do ta zgjas më shumë e të elaboroj edhe më shumë, por ka rënë në sy që është shkurtuar një buxhet shumë i madh prej RTK-së, afro 2,5

milione euro. Unë besoj se RTK-ja mund të përballët. Besoj se ministri i Financave ka arsyetimet ose ka ndonjë logjikë të kalohet edhe RTK-ja me këtë buxhet. Unë falënderoj dhe do të votoj këtë buxhet me rekomandime dhe amendamente. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, zoti Damka! Për fjalë është lajmëruar deputeti Shkëlzen Hajdini nga LDK.

SHKELZEN HAJDINI: Një gjë duhet ta kuptojmë mirë. Rrethanat aktuale politike kërkojnë maturi politike, kërkojnë mobilizim të gjithë spektrit politik, të gjithë aktorëve relevantë. Votimi i Buxhetit sot nënkupton funksionim normal të shtetit. Votimi i Buxhetit sot nënkupton që ne do të mund ta përballojmë sfidën që e kemi përpara. Mos votimi i Buxhetit sot nënkupton përgjegjësi. Ata që nuk votojnë sot Buxhetin duhet të marrin përgjegjësi. Sot duhet të lëmë anash procedurat a më ka thirrur në telefon, a s'më ka thirrur në telefon, koha ka qenë e caktuar. Duhet të mobilizohemi. Duhet ta aprovojmë Buxhetin. Të mobilizohemi jo vetëm për aprovimin e Buxhetit, të mobilizohemi edhe rreth masave të cilat i ka marrë Qeveria dhe rreth masave tjera të cilat do t'i marrë Qeveria. Unë si ekonomist tash do të dal në Buxhet.

Ky Buxhet që po flasim tani mund të mos jetë dhe i mjaftueshëm për përballimin e masave që mund të na shfaqen, të cilat duhet t'i marrim. Nëse e keni lexuar Buxhetin e shihni që Buxheti financohet nga të hyrat tatimore direkte dhe indirekte kryesisht. Të hyrat tatimore janë 1 780 000 000 euro. Masat që i kemi marrë tani dhe të cilat mund t'i marrim së shpejti nënkupton që do të afektohet drejtpërdrejt sektori privat dhe mund të paraqitet problemi i mbushjes së Buxhetit dhe shpenzimit të Buxhetit për nevojat të cilat do t'i kemi. Ju lutem, situata aktuale kërkon maturi, kërkon tejkalim të interesave politike. Nuk ka këtu interes të një partie politike. Ne dikush mund të mos i gëzohet funksionimit të Qeverisë, por tani duhet t'i gëzohemi, ngase një jetë nëse e shpëtojmë ne kemi bërë punë të mirë.

Ju lutem, ne jemi të vetëdijshëm për vërejtjet që i ka Buxheti, pranoi ministri, pranoi kryeministri. I kuptojmë rrethanat aktuale edhe një herë po e përsëris. I kuptojmë vështirësitë nëpër të cilat ka kaluar Qeveria, ristrukturimi i Qeverisë, koha e shkurtër, të gjitha. E kuptojmë çka duhet të përfshijë ky Buxhet. Ne e kuptojmë mirë që ne jemi 20 vjet pas çlirimit dhe ne e kuptojmë që sot koha kërkon tjetër buxhetim. Ne e kuptojmë që në Buxhet duhet të futet koncepti buxhetimi me perspektivë të zhvillimit ekonomik, por i kuptojmë edhe rrethanat e tanishme.

Nëse nuk votohet sot Buxheti, deputetë të nderuar, Kabinet Qeveritar, ne që i kemi pagat e mira ndoshta mund ta shtyjmë edhe ndonjë muaj, nuk do të kemi mundësi t'i paguajmë pagat, nuk do të kemi mundësi të ndajmë mjete për skemat pensionale, do të afektohet qytetari i shkretë drejtpërdrejtë, ndërsa ne ndoshta edhe mund ta shtyjmë edhe ndonjë ditë.

Ju lutem, të mendojmë për atë që ka nevojë. Neve qytetarët i kemi udhëzuar të rrijnë në shtëpi. Ata e presin një pagë që ta kalojnë, ta tejkalojnë këtë situatë. Edhe një herë po e përsëris, të gjithë ne deputetët jemi të vetëdijshëm që ne duhet të dalim nga mendësia e vjetër e të bërit buxhet, nga shkolla e vjetër e të bërit buxhet. Jemi të vetëdijshëm që neve na duhet një paradajm shift in. Neve na duhet të buxhetojmë për zhvillim ekonomik, neve na duhet të buxhetojmë për arsim, për përgatitje të fuqisë së kualifikuar punëtore dhe përballje me kërkesat e tregut, që mund të vijnë. Neve na duhet buxhetim për shëndetësi, megjithatë sot konsideroj që këto nuk janë të rëndësishme. Sot konsideroj që neve duhet të mobilizohemi, të veprojmë me maturi dhe ta votojmë Buxhetin e t'i dalim përball sfidave që na presin. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, zoti Hajdini! Fjala është për deputeten Vlora Nimani-Hajnuni nga LDK.

VLORA NIMANI-HAJNUNI: Faleminderit, kryesuese!

E nderuar kryetare!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Meqë kjo është një seancë e jashtëzakonshme dhe meqë Buxheti është një dokument voluminoz dhe ka qenë e pamundur të lexohet detajisht, unë do e ngre një pyetje dhe të njëjtën kohë edhe një çështje, e cila sot është problematikë dhe me të cilën sot po ballafaqohen më së shumti një kategori pak më e veçantë e jona e ata janë punëtorët shëndetësor.

Do e ngre çështjen e kontratës kolektive të punëtorëve shëndetësor, gjegjësisht implementimin e kësaj kontrate në kujdesin parësor shëndetësor. Përderisa ditëve të kaluara Ministria e Financave në bashkëpunim me kryetarët e komunave janë dakorduar që në ndarjen e tanishme buxhetore të aprovojnë një shumë prej 1,3 milion eurove në grantin specifik për arsim, për implementimin e kontratës kolektive në arsim, fusha e shëndetësisë nuk është përmendur fare. Është e njëjta problematikë me kontratën kolektive në arsim, që fatmirësisht është zgjidhur, ose po i jepet kahje e zgjidhjes së kësaj problematike.

Punëtorët shëndetësor në kujdes parësor shëndetësor, po flas për kujdesin parësor, sepse nuk e di kujdesin dytësor dhe tretësor, nëse implementohet kjo kontratë kolektive ende nuk mund t'i gëzojnë benefitet e kësaj kontrate, qoftë për shkak të buxhetit të vogël të komunave, ose për shkak të limiteve buxhetore që përcaktojnë qarkoret buxhetore të Ministrisë së Financave nëpër komuna.

Prandaj, zoti ministër i Financave, në qoftë se nuk është e planifikuar në këtë dokument, unë mendoj që ju duhet të planifikoni një shumë të përafërt me arsimin, me fushën e arsimin, në mënyrë që punëtorët shëndetësor të kujdesit parësor shëndetësor të marrin benefitet e kontratës

kolektive me kohë dhe pa pasur nevojë të procedojnë me procedura gjyqësore në një rën anëe dhe në anën tjetër, të mos dëmtohen buxhetet e komunave kryesisht investimet kapitale nga këto procese gjyqësore.

Konsideroj që kjo problematikë duhet të zgjidhet përmes këtij Projekt-buxheti, sidomos në këtë kohë kur profesionistët shëndetësorë, siç e tha edhe kryeministri dje në një konferencë për shtyp, po përballen dhe janë në vijën e parë të frontit me pandeminë e corona virusit, që ka shpërthyer edhe në Kosovë. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetarja e Kuvendit, znj. Vjosa Osmani-Sadriu.)

KRYETARJA: Faleminderit!

Vetëm një sqarim, meqenëse u përmend disa herë Ligji për paga, do të ishte e kundërligjshme sikur ne të fillonim sot ta implementonim një ligj i cili ende është i pezulluar nga Gjykata Kushtetuese. Kështu që, për fat të keq, përkundër dëshirës, një gjë e tillë do ta bënte tërë Ligjin për Buxhetin kundërkushtetues në qoftë se ne do ta futnim Ligjin për paga qysh tani, pa e marrë një përgjigje të Gjykatës Kushtetuese.

Deputeti Ardian Shala e ka fjalën.

ARDIAN SHALA: Faleminderit!

Përshëndetje, e nderuar kryetare!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Duke analizuar Projekt-Buxhetin për vitin 2020 pash se disa projekte ishin përgjysmuar, por edhe disa të tilla që nuk figuronin fare. Ajo çka pash te fjalimi i përfaqësuesit të AAK-së, ku komplet ankesat dhe vërejtjet e njëjta i kishte për disa komuna, ku të gjitha doli se janë komuna që udhëhiqeshin nga AAK-ja apo që udhëhiqen nga AAK-ja, siç është Gjakova, Deçani, Obiliqi, Rahoveci, Suhareka, e tjera.

Atëherë, kolegë të nderuar, a e dini cili ishte përfundimi që arrita ta nxjerr nga kjo, se pikërisht është shpërndarja e barabartë e Buxhetit nëpër të gjitha komunat e planifikuara në këtë Projekt-buxhet për vitin 2020 ajo e cila, si duket, ka prekur komunat e qeverisura nga AAK-ja, që për koincidencë “2 vjet me radhë” kryeministër ishte Ramush Haradinaj, lider i AAK-së. Pra, po del që pikërisht kjo shpërndarje e balancuar e ka sjellë në këtë gjendje, ku ankesat më të mëdha na shfaqen nga përfaqësuesit e Aleancës.

Duke e kuptuar gjendjen e jashtëzakonshme që është në Kosovë lidhur me pandeminë e corona virusit duhet të mirëkuptojmë seancën e sotme dhe duke ditur se shumë punëtorë do të mbeteshin pa pagat e tyre, duhet ta mbështesim këtë buxhet, edhe pse është një ligj i cili në kushte normale, normalisht që do të duhej të trajtohej më gjatë. Dhe, si të tillë unë këtë Buxhet do ta mbështes.

Ndërsa, për fund kam një kërkesë për ministrin e financave, ku disa kohë më parë ish-punëtorët e “Ballkanit” i kanë disa ankesa, ku në një vendim të para pesë viteve, Qeveria e udhëhequr atëherë nga ish-kryeministër Hashim Thaçi u pati ndarë me një vendim pagat për vitet ‘90-‘99. Ju lutem, zoti ministër, që të ndërmerrni diçka që kjo kategori mos të maltretohet më dhe ta gëzojnë të drejtën e tyre. Faleminderit për mirëkuptim!

KRYETARJA: Ministri Lumir Abdixhiku e ka kërkuar fjalën.

MINISTRI LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryetare!

I nderuar kryeministër,

Kolegë ministra,

Të nderuar deputetë,

Meqenëse tema e infrastrukturës u ngrit disa herë në diskutimet paraprake e shoh të udhës t’i bëj disa qartësime në emër të Ministrisë. Tashti pa paragjykuar rëndësinë e asnjërit projekt, projekteve të prezantuara këtu, por jo për nga burimi regjional i projektit por për nga perspektiva e një balance gjithëpërfshirëse në Kosovë.

Dua të them që asnjë projekt i kontraktuar nuk është larguar prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, porse në ditën e parë të punës në Qeveri kemi gjetur në gjendje alarmante. Vetëm në fushën e projekteve infrastrukturore sot për sot janë të kontraktuara plotë 180 milionë euro më shumë se sa qarkorja buxhetore që ka ekzistuar edhe me Buxhetin e kaluar, edhe me Buxhetin e tanishëm. Jo 180 euro, po 180 milionë euro më shumë.

Vetëm për shpronësime mungojnë 160 milionë euro. Hera e fundit që është shpronësuar diçka në Kosovë ka qenë në vitin 2017. Së bashku këto dy shuma bëjnë hiç më pak se 340 milionë euro, 340 milionë euro! Dhe, nuk po flas këtu për 50 milionë eurot shtesë të Bechtelit që Qeveria i ka anuluar e as për 110 milionë tjera që pretendoheshin t’i jepeshin jashtëligjshëm, të cilat të gjitha bashkë do të bënin gjysmë miliard euro para mangut. E kjo është masakra e Buxhetit që është provuar të bëhet, kur kontrakton gjysmë miliardë euro më shumë se sa që ke para të parapara me Buxhet.

Në prioritetet e Qeverisë së tanishme nuk është thirrës regjionalizmi, as mahalla, sado që janë të rëndësishme këto projekte. Por, prioritet është shtrirja e balancuar në të gjithë rajonet e Kosovës. Për shembull, për Qeverinë, pjesën e Dukagjinit, autostrada e vërtetë e Dukagjinit për Qeverinë është rruga Prishtinë - Pejë, 32 kilometrat e autostradës Kijevë - Zahaq. Ky Parlament tre vite më

parë ka aprovuar kredi. Qeveria e Kosovës ka një kohë të gjatë që paguan interesin e kësaj kredie dhe autostrada nuk ka nisur. A e dini pse s'ka nisë?

Sepse, Qeveria e kaluar për shkak të një pozite të një militanti të caktuar e ka ngrirë të gjithë projektin, sepse projekti është financuar prej BERZH-it e kur financohet prej BERZH-it rregullat e prokurimit nuk janë të Kosovës, por janë të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Kemi pranuar letër, paramendoni, letër kemi pranua prej BERZH-it për ankesat dhe vonesat një kredi 200 milionëshe, që nuk implementohet ende. Kjo është autostrada e Dukagjinit, lidhja e Pejës me autostradë në Prishtinë, projekt që po pret.

Kemi balancuar që përveç Dukagjinit të ndërtojmë dhe të lidhim edhe veriun e Kosovës, rrugën Prishtinë - Mitrovicë që ka nisur që 11 vjet, e që për arsye të thjeshta të koordinimit e shpronësimit e shpronësimit veçse e kemi kryer në mbledhjen e kaluar, nuk vazhdon të kryhet. Njëri prej qyteteve më të rëndësishme të Kosovës, njëri prej regjioneve më të rëndësishme të Kosovës, Prishtinë - Vushtri - Mitrovicë.

Përveç Dukagjinit e veriut kemi vendosur ta lidhim Llapin me rrugën magjistrale Besi - Podujevë. 20 000 vetura në ditë kalojnë nëpër këtë rrugë. Është rruga me aksidentet më të mëdha në Kosovë, po ashtu e nisur kaheerë, e papërfunduar. Kemi vendosur ta vazhdojmë autostradën Prishtinë - Gjilan, sipas rregullave ligjore gjithsesi. Duke pasur mjete dhe ndarje buxhetore proporcionale me mundësitë që i ka Kosova. Dhe, kemi vendosur ta lidhim edhe Drenicën me autostradë duke vazhduar projektin Skenderaj - Komoran.

Të gjitha këto projekte janë të përfshira në Buxhetin e Kosovës dhe nuk janë regjionale, nuk janë lokale, nuk janë të mëhallëve. Është një hartë gjithëpërfshirëse që brenda mandatit e lidh, edhe Pejë, edhe Mitrovicën, edhe Podujevën, edhe Gjilanin, me kryeqytet.

Dhe natyrisht, meqenëse u përmend autostrada, rruga Plavë - Deçan. Unë veç e kam takuar kryetarin e Deçanit. Ka probleme me zonat e veçanta të mbrojtura, por është prioritet absolut i Qeverisë. E gjeni në pikën 2 të Programit Qeveritar, që kjo magjistrale është prioritare. Mjetet janë të dedikuara, sapo të zgjidhen problemet pronësore do të vazhdojë edhe puna. Por, mos harroni edhe diçka, të gjitha projektet e Programit Qeveritar s'bëhen vitin e parë të Buxhetit. Buxheti është njëvjeçar e programi është katërvjeçar. Pas katër vitesh do të na matni me projektet që i kemi prezantuar në këtë Buxhet.

Unë besoj që po e bëjmë për herë të parë, për herë të parë, po e bëjmë një shtrirje infrastrukture pa interesa partiake e pa interesa lokale, por me një gjithëpërfshirje dhe me një plan mirë të menduar nacional, gjithmonë duke pasur parasysh, mbani në mend këtë, 340 milionë euro mangu që i kemi sot. Sot i kemi 340 milionë euro më pak për projekte të kontraktuara. E kjo është gjendja që na e ka lënë Qeveria e kaluar. 340 milionë euro më pak dhe kërkojnë projekte të

fantazisë, derisa ato që i kanë aty, me kredi, me 200 milionë euro kredi të BERZH-it, që tre vite s'i kanë nisur. Me 200 milionë euro kredi të BERZH-it, që tre vite s'i kanë nisë. Po mendoj që kjo mendësi veç ka ndryshuar tanimë. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Ilir Tasholli e ka fjalën.

ILIR TASHOLLI: Faleminderit, kryetare!

Përshëndetje kryeministër!

Kabinet Qeveritar,

Kolegë të nderuar,

Sikur po krijohet përshtypja që krejt këto seanca të jashtëzakonshme komplet fokusi shkon në aspekt periferik. Nuk diskutohet asnjëherë për çështje për të cilat jemi thirrur. Edhe kjo seancë sot që jemi këtu, si duket paraprakisht edhe prej kolegëve të opozitës, doli komplet jashtë fokusit.

Krijohet përshtypja që ne jemi në një situatë, ose jetojmë në një planet tjetër dhe nuk është duke ndodhur asgjë në Kosovë. Ne po flasim për, pa e humbur rëndësinë e projekteve, për projekte të ndryshme nëpër qytete të Kosovës e askush s'e përmendi se sot tri komuna të Kosovës janë në karantinë. Është qyteti i Vitisë, qyteti i Klinës, qyteti i Malishevës dhe për asnjë ne nuk e dimë deri nesër se edhe sa komuna të tjera mund të futen në karantinë.

Ne jemi me një buxhet të pa aprovuar. Bashkimi Evropian po ndanë fonde shtesë për atë që sa kanë nevojë shtetet e Bashkimit Evropian po ndan fonde shtesë. Ne jemi duke diskutuar akoma a po e aprovojmë një buxhet apo nuk po e aprovojmë. Mendoj që është momenti i fundit, meqenëse është situata kështu si është, komplet qytetarët e Kosovës janë duke na parë prej shtëpive të tyre. Ne jemi përfaqësuesit e popullit dhe kemi obligim që sa më shpejt të ulemi dhe ta aprovojmë. Bile më pëlqeu pak më herët edhe propozimi me e lënë tre minuta e mos me e lënë as dhjetë minuta më fjalimet e deputetëve. Nuk kemi kohë për të humbur.

Mendoj se këtu do të duhet të rrimë edhe sot, nesër e pasnesër, për shkak se nëpër situatën që po kalon vendi nuk kemi asnjë minutë tjetër për të humbur. Faleminderit!

KRYETARJA: Valentina Bunjaku-Rexhepi e ka fjalën.

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: Faleminderit, e nderuar kryetare e Kuvendit!

I nderuar kryeministër,

Kabinet Qeveritar dhe ju kolegë deputetë,

Në përgjithësi Projekt-buxheti është i qëndrueshëm, funksional, zhvillimor dhe me tendencë të rritjes së tij progresive. Ka shkurtime në organizata tjera në mënyrë të qëlluar. Është buxhet i arsyeshëm, që mund të ketë implikime pozitive në zhvillim ekonomik po edhe shkon shumë për paga dhe mëditje.

Nuk zgjidh problemin e pensionimit të përkohshëm të mësimdhënësve me probleme shëndetësore apo kjo paraqet problem në rast të zbatimit të Ligjit të pagave, i cili është i pezulluar në Gjykatën Kushtetuese. Për shumë vjet Buxheti i Kosovës ka qenë kryesisht për autostrada, ndërsa ky Buxhet i kushton pak më shumë rëndësi shëndetësisë, arsimit, zhvillimit ekonomik dhe infrastrukturës së ushtrisë.

Megjithatë, unë propozoj që të kemi disa ndryshime eventuale e sidomos për organizatat buxhetore të nivelit lokal, përkatësisht në projektet e Gjilanit, prej nga edhe vij. Te kodi 0941, ndërtimi i kampusit Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan duhet të shtohet po ashtu Buxheti. Ka kohë të gjatë që është diskutuar për këtë kampus dhe në mungesë të infrastrukturës ky universitet paraqet shumë probleme të mëdha.

Te kodi 0912, edhe pse shkruan se data e fillimit të mbarimit është në muajin e tretë të vitit 2020 e deri në muajin e dymbëdhjetë të vitit 2021, projekti i ndërtimit të shkollës në Livoç të Poshtëm në Gjilan duhet patjetër të jetë pjesë e këtij buxheti.

Te kodi 0443, projekti rruga nacionale Prishtinë - Gjilan besoj që vlera, e cila është e paraparë në këtë autostradë nuk është e mjaftueshme. Komuna e Gjilanit duhet të përkrahet më shumë në Buxhet, pasi që të gjithë e dini që ne po ballafaqohemi edhe me mungesë të ujit të pijshëm, vështirësi në sistemin e ujitjes së tokave bujqësore, por edhe po përballemi shumë edhe me ujëra të zeza në fshatra, të cilat duhet të ndihmohen urgjentisht, sepse është në pyetje edhe shëndeti publik.

Mendoj që në këtë Projekt-buxhet, të cilin sado pak mund ta shohim, Gjilani është dëmtuar me disa projekte kapitale. Po i them konkretisht: rregullimi i shtratit të lumit Nishorka me 500 mijë euro; rregullimi i shtratit Zhegër me 300 mijë euro; rrugët urbane të qytetit me 800 mijë euro; infrastruktura në Pogradjë me 395 mijë euro; shtrati i lumit Përlepnice me 345 mijë euro.

Unë bashkë me kolegët e mi do t’i përgatisim amendamentet dhe besoj që këto amendamente do t’i përkrahni ju, kolegë të mi deputetë. Faleminderit!

KRYETARJA: Ekrem Hyseni e ka fjalën.

EKREM HYSENI: E nderuar kryetare e Kuvendit,

I nderuar Kabinet Qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Meqenëse, sot jemi mbledhur për të diskutuar punën e Buxhetit të Republikës së Kosovës, mendoj se sot kemi pasur nevojë të diskutojmë shumë çështje, sa i përket Buxhetit. Por, situata e krijuar lidhur me infeksionin me virus, pra coronavirus e ka ndryshuar komplet qasjen dhe

gjendjen në të cilën jemi. Kjo sot neve na detyron që të marrim hapa më të shpejt dhe të jemi më aktivë, edhe në drejtim të menaxhimit të situatës, edhe në drejtim të daljes ndihmë.

Prandaj, unë sot kisha dashur që si pjesë e këtyre diskutimeve, ndoshta do të ishin bazike diskutimet se si t'i ndihmojmë komunitat e prekura dhe që janë të izoluar. Diskutim tjetër që do të ishte sot këtu është edhe se si ta mbrojmë stafin mjekësor dhe t'u ofrojmë kushte optimale për punën e mrekullueshme që janë duke e bërë. Pikë tjetër e diskutimit po ashtu, do të ishte marrja e masave shtesë për mos përhapje të virusit dhe mendoj që kemi këtu hapësirë ku duhet të bëjmë punë të tjera. Marrja e masave për mbrojtje të popullatës, mendoj se do të ishte kryesore dhe ky buxhet, një pjesë e tij, duhet të jetë tani e orientuar për këtë gjendje emergjente. Po ashtu, ajo që mendoj se sot është shumë e rëndësishme për t'u diskutuar dhe ndoshta, për Qeverinë me shkua si mesazh, është që t'u dalim ndihmë familjeve sociale që janë të izoluar dhe nuk kanë mundësi që të sigurojnë nevojat e tyre elementare ushqimore.

Për fund, unë kisha dashur edhe një propozim për Qeverinë, që për ta menaxhuar situatën me Corona virus duhet të shtohet buxheti për shëndetësi dhe buxheti emergjent për situatën e krijuar, ku do të ishte: shtimi i profesionistëve shëndetësor, të cilët nuk janë në marrëdhënie pune; shtimi i profesionistëve shëndetësor që janë në pension dhe duan të punojnë dhe kompensimi i orëve shtesë të cilën e bëjnë. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Lus Administratën që të na tregojë sa deputetë janë në sallë dhe ju lus, regjia, zilen që të gjithë deputetët të ftohen për votim.

A i keni në rregull pajisjet elektronike të gjithë? Po!

Ju lus që një herë të votoni për praninë. Votojmë tash për praninë elektronike! 61 janë të pranishëm. A ka dikush që nuk ka votuar? Edhe deputeti Fatmir Rexhepi, jemi 62.

Atëherë, edhe një herë ju lus të përgatiteni për votim për lexim të parë të Ligjit për Buxhetin. Votojmë tash!

Konstatoj që me 62 vota për dhe një votë me dorë, 63 për, kalon në lexim të parë Ligji për Buxhetin.

Para se t'i lus... A ka kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Regjia e konstaton që nuk ka, sepse nuk e di pse nuk më dalin në kompjuterin tim. Faleminderit!

62 vota për. Asnjë kundër, asnjë abstenim.

Para se t'i lus komisionet që të mblidhen për ta shqyrtuar Ligjin për Buxhetin, ju njoftoj se kemi disa zëvendësime me deputetë.

Nga Lidhja Demokratike e Kosovës në Komisionin për Integritet Evropian do të jetë deputeti Fidan Rekalu. Në Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Infrastrukturë dhe Ambient, deputeti Xhavit Ukaj. Në Komisionin për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes, deputeti Hatim Baxhaku. Në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike, deputetja Besa Gaxherri. Në Komisionin për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, deputeti Shkumbin Gashi.

Kurse, nga Lëvizja Vetëvendosje ju njoftoj që në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike do të jenë deputetët Enver Haliti, Eman Rrahmani dhe Arta Baraliu. Në Komisionin për Legjislacion do të jetë deputeti Alban Hyseni dhe në Komisionin për Shëndetësi, deputeti Fitim Haziri. Edhe i fundit, në Komisionin për Arsim, Shkencë e Teknologji, në vend të deputetes Arbërie Nagavci, do të jetë deputeti Fitim Uka.

Pra, këto janë njoftimet. I lus që të gjithë deputetët, edhe këta të rinjtë... Urdhëroni, deputeti Albert Kinolli. Lidhur me këtë temë po supozoj, zoti deputet. Deputeti Kinolli e ka fjalën.

ALBERT KINOLLI: Gjithsesi, kryetare e nderuar!

Kohë më parë, para disa ditësh e kemi njoftuar me shkresë sekretarin e Kuvendit për zëvendësim në Komisionin për Komunitete dhe Kthim. Mendoj që vendimi është i gatshëm.

KRYETARJA: A mund ta lexoni, ose propozimin... zoti deputet, sepse nuk na ka ardhur.

ALBERT KINOLLI: E ka Sekretaria.

KRYETARJA: Vetëm një moment, të lutem!

(Ndërprerje e incizimit)

Zoti deputet, te rasti i zëvendësimit të Komisionit për Komunitete ekziston nevoja që të shqyrtohet në Kryesi, për shkak se Kushtetuta parasheh përfaqësimin e secilit komunitet, e jo përfaqësimin e grupeve parlamentare, ky është arsyeja që tani e mora.

A mund të afroheni deputet Kinolli, ju lutem, që në emër të Grupit 6+ ta sqaroni për një minutë shkresën tuaj? Faleminderit!

(Ndërprerje e incizimit)

KRYETARJA: Atëherë, ju njoftojmë po ashtu që Grupi Parlamentar 6+, pasi deputetja Emilija Rexhepi është bërë ministre, vendin e saj e ka zënë deputetja Zikreta Aliti, kurse Grupi 6+ në këtë rast si përfaqësuese të komuniteti boshnjak e propozon deputeten Zikrete Aliti për nënkryetare të Komisionit për të Drejta dhe Interesa të Komuniteteve. Pra, ky është zëvendësimi në këtë komision.

Tani, për të gjitha këto zëvendësime që i lexova nga këto tri grupe parlamentare, ju lus që të votojmë me dorë. Sa deputetë i kemi në sallë?

Në ndërkohë, derisa të numërohen deputetët, po ju njoftoj që ka ardhur edhe një njoftim nga Grupi Parlamentar i AAK-së, që nënkryetar në Komisionin për Buxhet dhe Transfere, në vend të deputetit Shkumbin Demaliaj, të propozohet deputeti Gazmend Abrashi.

Këto janë të gjitha njoftimet që i kemi për zëvendësime.

63 deputetë janë në sallë. Kush është për këto zëvendësime?

Faleminderit! A ka kundër? Nuk ka. A ka abstenim? Nuk ka!

Atëherë, me 63 vota për bëhen zëvendësimet në komisionet përkatëse.

I lus katër komisionet e përhershme që menjëherë të mblidhen për ta shqyrtuar Ligjin për Buxhetin dhe shpresoj që për një kohë rekord të na befasoni me efektivitetin tuaj në shqyrtimin e këtij ligji.

Unë po pres që në orën 21:00 komisionet ta përfundojnë punën. Po synojmë që në orën 21:00 ta përfundojnë punën, kurse ne të mblidhemi në orën 21:30 këtu për leximin e dytë. Faleminderit!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*